

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i projektaktit

Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Konkretisht, për projektvendimin “(Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026”). për të cilët konsultimi publik është mbyllur, kemi bërë publikimin në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit (RENJK) <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/349> dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë: <https://arsimi.gov.al/draft-strategjia-kombetare-e-arsimit-2021-2026/>. Projektvendimi ka qenë i publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimit (RENJK) nga data katërmëdhjetë maj 2021 deri me datën shtatë qershor 2021. Ndërkohë që janë zhvilluar takimi në kuadër të konsultimit përgjatë gjithë muajit maj dhe qershor 2021.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

1. Konsultimet elektronike, njoftuar përmes Regjistrin Elektronik, RENJK:
2. Takimet publike në datat
3. Komunikimi përmes postës elektronike nga data

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Në këtë kuadër janë zhvilluar një sërë takimesh publike/konsultative, si vijojnë:

Në datë 14 maj 2021 u mbajt takimi me Këshillin Kombëtar të Arsimit Parauniversitar në të cilin morën pjesë anëtarët e këshillit, përfaqësues të sindikatave, Save the Children,

Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, Ministria e Diasporës.

Në datë 20 maj 2021 u mbajt në ambientet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë takimi me Këshillin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor ku morën pjesë fizikisht por dhe online përfaqësuesit e këtij këshilli.

Në vijim të procesit të Konsulimit Publik u mbajtën takime konsultative me 4 Drejtoritë Rajonale të Arsimit Pauniversitar (DRAP) përkatësisht, 21 maj 2021 DRAP Durrës, 24 maj 2021 DRAP Fier, 28 maj 2021 DRAP Korçë, 31 maj 2021 DRAP Lezhë. Në këto takime morën pjesë, përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore, prindër, mësues, drejtues shkollash, nxënës, punonjës psikosocial, oficerë sigurie etj.

Në datë 27 maj 2021 u zhvillua takimi me Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) publike dhe jopublike në Shqipëri.

Në datë 31 maj 2021 u zhvillua takim me Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik të Kuvendit të Shqipërisë ku u diskutua mbi sugjerime dhe propozime të vlefshme mbi vijimin e reformave në arsim si dhe hartimin e një strategjie sa më gjithëpërfshirëse dhe me një ndikim të drejtpërdrejtë në ritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Në datë 1 qershor 2021 u zhvillua takimi me Grupin Ndërinstitucional të Punës të kapitullit 26 në të cilin morën pjesë anëtarët e grupit të punës. Gjithashtu po në datë 1 qershor 2021 u zhvillua në ambientet e MASR një takim më nxënës ku morën pjesë dhe drejtuesi i UNICEF në Shqipëri si dhe Krye Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në datë 2 qershor u mbajt takimi me Shoqërinë civile në të cilin morën pjesë përfaqësues të shoqatave të ndryshme, OJQ dhe aktorë të ndërlidhur me fushën e arsimit.

Në datë 4 qershor u mbajt takimi me Grupin Tematik të Grupit të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) ku morën pjesë përfaqësues nga Kryeministria, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, MASR, etj.

Në datë 11 qershor 2021 u mbajt takimi me Donatorët ku morën pjesë përfaqësues të njësive diplomatike në Shqipëri si: Ambasada Gjermane, Ambasada Franceze, Ambasada Italiane, Ambasada e Kosovës, Ambasada e Spanjës, Këshilli i Evropës, British Council, OSCE, Save the Children, UNICEF, Agjencia Austriake për Arsim etj.

Pas përmbylljes së këtij procesi të gjerë konsultativ u mblodhën të gjithë komentet e ardhura, sugjerimet të cilat u vlerësuan nga grupet përkatëse të punës/tematike të ngritur me urdher Ministri.

Pasqyra e komenteve të pranuar me arsytimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
1. Klasat kolektive	Në strategjinë aktuale flitet shumë për reduktimin e klasave kolektive. Klasat kolektive kanë qenë një e keqe e domosdoshme sepse duke qenë se arsimi bazë është i detyruar edhe pak fëmijë të ketë në zona rurale sidomos të ketë klasa kolektive por këshilla ime është që të ketë një studim. Në buxhet të ketë një studim në nivel kombëtar për mënyrën se si mund të shmanget klasa kolektive për racionalizimin e shkollave. Kjo gjë është thënë vazhdimisht por nuk është bërë, kjo do të rriste pak kostot e transportit, por do ta bënte Shqipërinë të ngjashme me vendet e rajonit dhe komunitetit europian në raportin mësues nxënës. Sigurisht kjo kërkon disa masa sensibilizimi për komunitetin që ka të bëjë me lëvizjen por që do të ketë impakt, do të ketë cilësi. Ka ardhur koha që të bëhet kjo gjëja.	Këshilli Kombëtar i Arsimit Parauniversitar (KKAP)	Pranohet	Është adresuar në objektivin A1.3, masa reformuese 15

2. Strukturat e MAS	Vazhdimisht historikisht kanë ndryshuar strukturat e ministrisë së Arsimit, dikur ka qenë sektori i kualifikimit i veçantë dhe tani ka ASCAP ka dhe drejtori të përgjithshme të arsimit, ndoshta duhet parë edhe një herë nëse do të jenë po këto struktura në strategji apo do të ketë ndryshime duke e lidhur shumë me mbivendosjen e roleve në struktura sepse kjo pastaj mund të çojë në disa ndryshime në produkte brenda vetë strategjisë		Refuzohet	Nuk lidhet me diçka që do të ndryshojë strategjinë
3. Kurrikulat	Sugjerimi i fundit ndoshta kërkohet një studim që ka lidhje me politikën C që është arsimi i lartë ajo që mungon është koherenca kurrikulare mes dy sistemeve. Sistemi arsimor parauniversitar po punon me kurrikulën me kompetenca dhe kjo gjë duhet parë se sa koherente shkon me kurrikulën universitare. Kjo do të ishte një gjë shumë e mirë që duhet marrë në konsideratë nga ana e Ministrisë.		Pranohet pjesërisht	E adresuar në objektivin A.3.2
4. Mësimi Online	Desha të sugjeroja nëse gjeni hapësirën e mundur diçka në lidhje me mësimin online . Sigurisht që mësimi online ishte një fakt përpara të cilit ne u ndodhëm të papërgatitur dhe ishte globale pasi e gjithë bota nuk kishte atë aksesin optimal siç mund të pretendohet. Pra unë nuk e di se sa mund të jetë përfshirë në strategjinë e re një mundësi e tillë e të mësuarit online. Sigurisht që edhe univeristetet tona e kanë patur si opsion mësimin online sepse ka patur kurse të ndryshme që referoheshin online por një ngërç i tillë askush nuk mund të na sigurojë që nuk mund të përsëritet më prandaj në strategjinë e re mund të parashikohet edhe disa objektiva apo synime sigurisht të bëjmë një parantezë duke thënë se nuk jam shumë në brendësi për shkak të kohës.		Pranohet pjesërisht	Është adresuar në strategji

5. Fond pyetjesh për maturën shtetërore	Gjithashtu e dyta u fol për produktin për startegjinë dhe unë do të ndalesha tek produkti. Gjithmonë e tha dhe zotëria dhe unë e mbështes fjalën shumë të arsyetuar të zotërisë parafolës. Kemi patur ngërçe me maturën shtetërore dhe specifikisht në lëndën e gjuhës dhe letërsisë që është bërë vazhdimisht për shkak të interpretimit të natyrës interpretuese që ka letërsia ajo është një pikë e dobët. Mendoj shpeshherë që edhe tekstet pararendëse përgjatë viteve janë lënë në aftësinë e mësuesit dhe shpeshherë në pasigurinë e mësuesit prandaj mendoj që duke qenë ministria administrues a do të ishte mirë që për këtë 4 vjeçar të mendohet të krijonim një bankë testesh ku edhe mësuesi të ishte i lirë në testim. Një banko testesh që të ishte e konceptuar në përputhje me aftësitë e nxënësit në përputhje me ato aftësitë moshore të vitit, pra të ishin të kombinuara të gjitha këto. Kjo do ta çlironte mësuesin do ta bënte më të aftë një nxënës drejt provimit final të maturës shtetërore dhe them se do ta minimizonte diçka atë kaosin që krijohet gjatë maturës shtetërore. Në fakt unë dukë qenë specialiste e gjuhës i referohem gjuhës nuk jam shumë e mirëinformuar për lëndët e tjera por vazhdimisht gjuha dhe letërsia e kanë patur duke qenë se letërsia ka gjithmonë interpretim. Prandaj mendova mos do ishte mirë që të krijonim një hapësirë për krijimin e një banko testesh e cila do të na minimizonte shumë problematika që do të dilnin dhe e fundit është prapë një ngacmim që kam marrë nga një nga konferencat ku kam marrë pjesë bashkë me kolegë.		Pjesërisht pranohet ideja e bankës së pyetjeve	Në strategji mund të shtohen produkte për përgatitjen e nxënësve për provimet e Maturës Shtetërore dhe përprovimet kombëtare të arsimit bazë (materiale ndihmëse me modele të llojeve të pyetjeve, me modele pyetjesh që matin njohuri dhe aftësi të ndryshme dhe me modele testesh për të gjitha lëndët që janë provim)
--	---	--	---	---

6. Kurrikulat	E katërta që doja të thoja mund ta kapërcejë pak natyrën e mbledhjes apo synimin e kësaj mbledhje por gjithsesi është një shqetësim që unë do ta them dhe mund ta shikoni ose jo të arsyeshëm. Nga raportet krahasuese në kurrikulat e vendeve të tjera unë kam konstatuar që kurrikulat janë shumë të ndjeshme apo të lëvizshme sipas problematikave të ndryshme që sjellin kontekste të ndryshme profesionale qoftë historike të vendeve të ndryshme, ndërsa ne kemi mbetur në një kurrikulë e cila ka disa vite që aplikohet ka disa vite që nuk ndryshon ndërkohë që kontekstet sociale kulturore historike demografike etj etj kanë ndryshuar. Mos është momenti për ta riparë kurrikulën. Këtu jam thjeshtë në kushte sugjerimi por shumë nga larg.		Refuzohet pjesa e rishikimit të kurrikulës	Kurrikula e re e arsimit parauniversitar ka filluar zbatimin në vitin 2014. Kjo kurrikulë përafrohet me kurrikulat e vendeve evropiane dhe reflekton anët e mira të kurrikulës së mëparshme. Për këtë arsye nuk mund të ketë rishikim të kurrikulës së shpejti. Së dyti ndryshimet e shpeshta në kurrikulë ç'orientojnë shkollën dhe mësuesit.
---------------	--	--	--	--

7. Emërimi i mësuesve	Është pak problem sepse fillon konkurimi i mësuesve me dosje dhe ka shumë problem për këtë sepse jemi marrë dy vite dhe po të merremi dy orë me grupin e ministrisë. Nuk vlerësohet eksperienca në punë sepse një mësues me disa vite punë barazohet me një mësues të ri dhe kjo krijon shumë probleme. Ka edhe të tjera por kjo është ajo më kryesorja prandaj unë mendoj se kjo duhet zgjidhur sa më parë.			

8. Transporti	Duhet zgjidhur gjithashtu edhe problemi i transportit ne e kemi diskutuar edhe gjatë debatit në distancë por ky nuk ka një problem buxheti mendoj unë sepse është një vendim i këshillit të ministrave për transportin por me krijimin e zyrave të reja arsimore ky del një problem me zyrat e financave sepse distanca është nga qendra e punës për në zyrën arsimore. Ne duhet të kalojmë në një rritje ta cojmë ne 3,5 . Dhe nëse ne arrijmë këtë dhe më tej ta cojmë aq sa vëndet e BE them se do arrijmë të themi që kemi bërë punë të mirë. Sepse ky është arsimi. Është prioritet.			
9. Nisma "Bëjmë detyrat e shtëpisë"	Strategjia përmend nismën bëjmë detyrat e shtëpisë . Unë them ta kthejmë në objektiv. Sepse nxënësit nuk mund të qëndrojnë në shkollë deri në orën 13 sepse ka një problem të madh me prindërit, ata janë në punë dhe ku do të shkojë fëmija. Prindi është i detyruar ta çojë në një shkollë private dhe jopublike po kjo ka problem socila. Dhe ne jemi për arsim falas sepse ai detyrohet të paguajë diçka. Prandaj në këtë kuadër ne do të shkruajmë që nxënësi duhet të qëndrojë në shkollë deri në orën 16 ose të përputhet ose të afrohet me orarin kur kthedhen prindërit nga puna .		Pjesërisht pranohet ideja e shtrirjes së nismës "Bëjmë detyrat e shtëpisë".	Në shkollat të cilat punojnë me një turn dhe kanë infrastrukturën e duhur mund të zbatohet nisma "Bëjmë detyrat e shtëpisë" (nr., mund të sigurohet nga pushteti vendor)
10. Rikonstrukturi i shkollave	Kjo një por dhe shkollat të riparohen për shembull Durrësi Tirana që janë truri dhe zemra e Shqipërisë po ndërtojnë shkolla të një niveli European dhe jo vetëm nisma bëjmë detyrat e shtëpisë por duhet të ketë aktivitete.			

11. Kualifikimi i mësuesve	Një pikë tjetër që mund të them është dhe kualifikimi i mësuesve . Ne këta mësues kemi, meni mësues të mirë siç kemi patur gjithmonë, por këta janë mësuesit tonë. Ato agjenci që merren me kualifikimin e mësuesve nuk them se nuk janë të përgatitur etj etj me radhë por detyra është tek drejtoritë arsimore. Është detyrë e drejtorisë që të mbikqyri këto institucione sepse këto agjenci po kthehen në një pazar. Është përgjegjësi e madhe kualifikimi. Ajo që ju thksuat pandemia ka patur shumë probleme por ka bërë revolucion. Atëherë ne na duhet të trajnojmë mësuesit sepse nuk mund të themi që mësuesit i kemi shumë të mirë por nuk janë në gjëndje të japin mësim me mjete moderne. Duhet ti trajnojmë.		Pranohet	Lidhur me monitorimin e trajnimeve të mësuesve do të dalë udhëzimi i ri i cili ngarkon grupet e monitorimit për të kryer vëzhgime të vazhdueshme
12. Përzgjedhja e drejtuesve të shkollave	Kam dhe një problem me drejtuesit e shkollave . Aty thuhet se ka probleme me drejtuesit e shkollave. Ka dhe drejtorë shumë të mirë ama një pjesë nuk i përgjigjen kërkesave të strategjisë. Janë zgjedhur me konkurse hera herës qesharake prandaj duhet të ndërhyrë detyrimisht shpejt. Nëse bëhet diçka për përzgjedhjen e drejtorëve në shkolla unë them se kemi bërë një hap shumë të madh në strategji.			

13. Arsimi parashkollor	Problem për mua mbetet arsimi parashkollor. Arsimi parashkollor tek ne mbetet rrugëve. I është lënë bashkive që nuk janë fare të fokusuar tek arsimi parashkollor dhe edhe në strategji pranohet që ka probleme. Ne mendojmë që arsimi parashkollor duhet të kalojë në varësi të MAS. Të shikohen kurrikulat. Unë nuk jam specilaist por në aktivitet ndërkombëtare që kam patur për fëmijë që janë në kopshte dy jane loja dhe natyra kurse ne i fusim në atë regjimin e klasës së parë që në moshën 3 vjeçare. Numri i popullimit është shumë i lartë. Dihet në qendër të Tiranës. Dihet që një kopësht shumë cilësor do të ndikojë shumë në formimin e fëmijës.		Pjesërisht pranohet sugjerimi për arsimin parashkollor	Përzgjedhja e teksteve ose paketave didaktike nga mësuesit parashkollorë, në përputhje me kurrikulën. Hartimi i një udhëzuesi për kriteret e përzgjedhjes së teksteve ose paketave didaktike në arsimin parashkollor
14. Arsimi profesional	I njeiti problem është edhe për arsimin profesional. Duhet që për të rregulluar arsimin profesional duhet të ketë më shumë fokus, sepse kemi kamariere me juridik dhe me sa kam lexuar nga ne akoma nuk e kemi njëfokus se çfarë duam të kemi specilaistë për bujqësinë apo diçka tjetër.		Refuzohet	Nuk është përgjegjësi e MAS

15. Trajnimet e mësuesve	Që të kemi një arsim cilësor ne duhet të kemi dhe mësues të mirë. Mësuesit kur janë periudh atë vështira na duken të mirë kur janë periudh apaqeje mësuesit nuk i kemi të mirë por të jesh mësues i mirë duhet të jesh i trajnuar dhe jo në mënyrë fiktive. Në kontratën kolektive është e përcaktuar qartë duhet të trajnohen. Ne mendojmë që këto agjenci fantazëm që egzistojnë të mos egzistojnë se janë formalitete. Ne nuk kemi shumë njohuri juridike por të akreditosh një universitet përveçse stafin duhet të kenë dhe ambientet. Unë nuk e di se ku i kanë ambientet këto agjenci fantazmë që shumë mësues na kapin duke na thënë na duhen 2 kredite apo më gjeni 1 kredit. Ne si sindikatë jemi që trajnimet të organizohen nga universitetet ato kanë stafe kanë ambiente dhe këto mësues të rinj për shembull që duan të trajnohen.			
--------------------------	---	--	--	--

16. Roli i arsimit në diasporë	Të rrisim rolin e arsimit në diasporë. Se si duhen gjetur rrugë duhen bërë plane. Nga pikëpamja strukturore me aq sa pamë është e vështirë për ta ndërtuar sepse spektri i arsimit është shumë i gjerë por janë rritur dhe këto parametrat e IPSIS-it që kush është marrë me të e di shumë mirë se sa duhet ti respektojmë ato. Për sa i përket konceptit kur shohim parimet realisht shënojmë një hap radikal pozitiv që tek gjithëpërfshirja apo tek arkitektura e mësimdhënies apo e long life learning por dhe tek objektivat por duhet të synojmë edhe tek outputet e kemi filluar me kompetencat por puna me teknologjinë realisht tek outputet duhet të jenë shumë më të qarta që këto janë produktet e kësaj strategjie. Pra çfarë presim. Sepse kemi diferenca të konsiderueshme me vendet e tjera do të thotë që një nxënës i yni nuk fillon të mendojë planifikimin, projekte ndërkohë që kush ka patur rast ti bëjë jashtë ata që në klasë të dytë fillojnë të mëndojnë për një projekt. E njehta gjë është dhe përdorimi i kompiuterit kjo ka të bëjë me praktikën konkrete. Nëse i detyrojmë nxënësit të punojnë në kompiuter dhe të na i dorëzojnë detyrat në kompiuter vetëm ashtu përvetësohen, e njehta gjë me gjuhën e huaj e njejt agjë nëse nuk i kërkojmë gjëra për mendësh por i kërkojmë analiza, përfundime, konkluzione përndryshe jemi mbrapa shumë në arsim. Unë them që do të zbatohet kështu si është shkruar dhe duhet të punojmë shumë për zbatimin e saj sepse ajo është faza më e rëndësishme.		Refuzohet ideja e projekteve.	Projektet janë pjesë e detyrueshme e zbatimit të kurrikulës dhe angazhimi i nxënësve në projekte vlerësohet çdo periudhë (3-mujor)
---------------------------------------	---	--	--------------------------------------	---

17.Politika universitare duhet të drejtohet në kërkesën e tregut	Programet duhen orientuar edhe në vendet perëndimore si Gjermania, Anglia, Franca dhe Spanja të cilat kanë universitete shumë të rëndësishme për sa i takon mësimdhënies. Nëpërmjet këtyre vendeve mund të bëhet lidhja me universitete dhe mendoj që është e vështirë sot që të bëhet lidhja e diplomave kjo do të ketë shumë punë për të bërë njohjen e diplomave nga filialet por jo nga universitete shtetërore sepse në vendet perëndimore ajo që i jep vlerë universitetit nga universitetet shtetërore por kjo do të realizohet nëse një universitet në Madrid do të bashkëpunonte me UT por hapja e filialeve shtetërore është shumë e vështirë. Kjo mund të bëhet vetëm me universitetet private këto janë 3 raportacionet e mia në këtë draft koleget me siguri do të kenë të tjera por mu duk një draft që është punuar në mënyrë shumë të kujdesshme por duhet të jetë një cikël me ambicioz me këto që unë thash dhe sidomos të krijohen lidhje me profesorë të ftuar. Unë kam qenë profesor i ftuar në shumë universitete në Madrid dhe në SHBA dhe kjo figurë duhet të vihet shumë në lëvizje ndofta jo në çështje ligjore por në çështje praktike dhe kjo i rrit vlerën universiteteve. Domethënë që politika universitare duhet të drejtohet në kërkesën e tregut	KALKSH	Refuzohet	Nuk është një propozim konkret në lidhje me ndonjë objektiv specifik
18.Pagat e pedagogëve	Mangësitë mbi sasinë dhe qëndrueshmërinë e financimit të arsimit të lartë dhe sidomos të kërkimit shkencor në Shqipëri, (financimi jo adekuat) që ka qenë mjaft penalizues ndër vite në zhvillimin e këtyre dy fushave. Përpos kësaj, në strategji rezulton të jetë përcaktuar synimi për të rritur në mënyrë të konsiderueshme pagat e mësuesve në arsimin parauniversitar, ndërkohë që nuk rezulton të jetë përmendur rritje e pagave të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë. Duke marrë në konsideratë mbingarkesën e pedagogëve, pamundësinë kohore për të zhvilluar kërkim-shkencor, raportin pedagog/student larg normës së vendeve të BE, etj, rritja e pagës së personelit akademik shfaqet si një domosdoshmëri. Jo vetëm	KALKSH	Refuzohet	Nuk lidhet me strategjinë. Synimi është që ky të jetë viti i fundit që pagat përcaktohet nga MAS (qeveria), sepse duhet që vetë universitetet (Bordi i Administrimit) të përcaktojnë pagat e pedagogëve. MAS

	që është e domosdoshme që të përfshihet synimi për rritjen e pagës në SKA, por kjo rritje duhet të jetë minimalisht sa ajo e mësuesve të arsimit parauniversitar për të njëjtën periudhë. Nëse nuk realizohet rritja, nuk do arrihet asnjë rezultat.			nuk mund të përcaktojë specifikisht rritjen e pagave, por mund të përcaktojë rritjen e transfertës për universitetet.
19. Ristrukturimin e institucioneve të arsimit të lartë	Propozimi për ristrukturimin e institucioneve të arsimit të lartë. Më specifikisht, z. _____ shprehet në favor të zvogëlimit të numrit të IAL-ve në Shqipëri, Madje edhe Duke filluar nga zvogëlimi i numrit të Universiteteve publike, me qëllim realizimit të shpërndarjes gjeografike dhe profilizimit më të mirë të IAL-ve në Shqipëri. Si shembull u morr copëtimi ndër vite i Universitetit të Tiranës në disa Universitete publike (aktualisht aktive në Tiranë) të cilat sipas z. _____ kanë prodhuar mjaft pasoja negative si p.sh rritje e kostove, rritje e burokracive administrative dhe rënie e efektivitetit në realizimin e misionit të tyre.	KALKSH	Refuzohet	Nuk lidhet me strategjinë. Synimi është që ky të jetë viti i fundit që pagat përcaktohet nga MAS (qeveria), sepse duhet që vetë universitetet (Bordi i Administrimit) të përcaktojnë pagat e pedagogëve. MAS nuk mund të përcaktojë specifikisht rritjen e pagave, por mund të përcaktojë rritjen e transfertës për universitetet.
20. Kërkimi shkencor	- Disniveli në pagesat midis pedagogëve të huaj dhe pedagogëve shqiptarë të cilët marrin pjesë në të njëjtin projekt kërkimor-shkencorë dhe bëjnë punë të ngjashme për nga volumi dhe kompleksiteti. Normalisht, në pjesën më të madhe të projekteve që angazhojnë pedagogë nga vende të ndryshme pagesat për secilin prej pjesëmarrësve indeksohen sipas legjislacionit të	KALKSH	Refuzuar	Rishikimi i ngarkesës, nuk u morë parasysh

	vendit ku punon me kohë të plotë secili pedagog i përfshirë në projekt. në lidhje me këtë çështje z. Hoxha propozoi që të përfshihet në strategji negocimi në funksion të zvogëlimit të hendekut midis pagesave që merren nga pedagogët e huaj dhe pedagogët shqiptarë pjesëmarrës në të njëjtin projekt, pasi pabarazia aktuale në pagesa nuk përkon me pabarazinë në punë midis pedagogëve të vendeve të ndryshme. - Z. _____ shtroi gjithashtu problematikën e ngarkesës mësimore të pedagogëve të Universitetit të Tiranës e cila duke qenë tepër e lartë, ndikon në kufizimin e kohës së pedagogëve dedikuar kërkimit shkencor.			
21.Ndërlidhja e arsimit me tregun e punës	Z._____ mendon se duhen përcaktuar sektorët prioritarë dhe të rregullohen praktikat mësimore dhe ato profesionale. Ai sugjeron që IAL-të të konsiderohen si qendrat e vetme të formimit vazhdues në profesionet e rregulluara dhe të kenë një rregullim të qëndrueshëm. Duhet ofruar programe trajnimit të vazhduar të cilat të verifikohen edhe nga ministria si psh. kurset në fakultete, trajnime, shkrimi akademik, gjuha e huaj etj.	KALKSH	Refuzohet	VKM kurset e mësimi të vazhduar jo më pak se 30 orë
22.Financimi I arsimit të lartë	Mangësitë mbi sasinë dhe qëndrueshmërinë e financimit të arsimit të lartë dhe sidomos të kërkimit shkencor në Shqipëri, gjë (financimi jo adekuat) që ka qenë mjaft penalizues ndër vite në zhvillimin e këtyre dy fushave. Përpos kësaj, në strategji rezulton të jetë përcaktuar synimi për të rritur në mënyrë të konsiderueshme pagat e mësuesve në arsimin parauniversitar, ndërkohë që nuk rezulton të jetë përmendur rritje e pagave të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë. Duke marrë në konsideratë mbingarkesën e pedagogëve, pamundësinë kohore për të zhvilluar kërkim-shkencor, raportin pedagog/student larg normës së vendeve të BE, etj, rritja e pagës së personelit akademik shfaqet si një domosdoshmëri. Madje sipas z. Hoxha jo vetëm që është e domosdoshme që të përfshihet synimi për rritjen e pagës në SKA, por kjo rritje duhet të jetë minimalisht sa ajo e mësuesve të arsimit parauniversitar për të	KALKSH	C2	

	njëjtën periudhë. Nëse nuk realizohet rritja, nuk do arrihet asnjë rezultat.			
23. Ndërkombë - tarizimi	Në lidhje me programet e përbashkëta të arsimit të lartë ka nevojë të strukturohet mirë nga ana normative pra të ketë akte nënligjore për njohjen e këtyre diplomave (programeve të përbashkëta).	KALKSH	Refuzohet	Është parashikuar në strategji
24. Vota e studentëve	Ne lidhje me peshën specifike të votës së studentit shprehet kundër rritjes së këtij elementi në vlerën 50%.	KALKSH	Refuzuar	
25. Kodifikimi	Kodifikimi. Z. _____ hapi një tjetër diskutim në lidhje me kodifikimin në nivelin minimalisht 70%, ku thekson se duhet të dalë nga MASR, nëpërmjet Këshillit të Ministrave, sipas fushave të studimit dhe nivelit, ngjashmëria e programeve gjë e cila do t'i disiplinonte të gjithë. Kjo do sillte një studim më të mirë të tregut të punës.	KALKSH	Pranuar	Adresuar në objektivin C1.1.3
26. Financimi i kërkimit shkencor	U soll shembulli personal në lidhje me financimin e kërkimit shkencor që ajo zhvillon ose ka zhvilluar dhe fleksibilitetin që IAL-ja i krijon duke hequr pjesën e ngarkesës mësimdhënëse (kohë e cila do përdoret për kërkimin shkencor). U propozua që drejtuesit e IAL-ve shqiptare minimalisht t'u heqin pedagogëve (që kryejnë kërkime shkencore) mbingarkesën mësimore, për të mbështetur kërkimin shkencor. Sipas znj. Telhaj thekson se nëse synohet rritja e cilësisë së IAL-ve duhet bërë në dy drejtime, atë të studimeve shkencore dhe mësimdhënien. Duhet të motivohen kërkuesit e për këtë ka nevojë për fonde me qëllim rritjen e konkurrencës së kërkuesve e cila do sillte rritje të cilësisë së kërkimit shkencor. Gjithashtu znj. Telhaj diskutoi edhe për bashkëpunimin me IAL-të e huaja.	KALKSH	Refuzuar	Nuk është një propozim konkret në lidhje me ndonjë objektiv specifik
27. Gjuha e huaj	Nuk arrita të shkruaj dot me pare edhe për një ceshtje tjetër që nuk e diskutova dot me ju në takimin që patëm në ministri me HERE. Diskutimi është për ceshtjen e gjuheve të huaja në arsimin parauniversitar, por gjithësesi nëse bëhet e mundur të diskutohet	KALKSH		

	do ishte nje kontribut shume pozitiv dhe i rendesishem edhe per strategjine dhe te gjithë arsimin shqiptar. Per kete po ju percjell edhe mendimin e kolegeve te gjuhe te huaja dhe ketu ne attach eshte dhe Dekania e FGJH Profesoresh Kromidha. Me sa kuptojme nga strategjia ideja e Ministrise eshte te implementoje qe ne klase te pare mesimin e anglishtes si gjuhe e huaj e detyruar. Nderkohe qe ne dijen tone ministria e arsimit po pergatit disa skenare per mesimin e gjuheve te tjera te huaja. Edhe pse anglishtja do te vendoset gjuhe e huaj e pare me detyrim nga klase e pare, propozimi yne strategjik eshte qe gjuha e huaj e dyte duhet te jete ne nivel B2 ne perfundim te klases se 12. Per te qene e tille ajo duhet te kete te njejtin numer oresh qe ka edhe tani si gjuhe e pare. Gjuha e dyte mund te filloje nga klase e trete ose me vone pak rendesi ka, por eshte e rendesishme te zhvillohet me aq ore sa te arrihet niveli B2. Gjuha e huaj e dyte mund te jete gjuhe studimesh (brenda dhe jashte vendit)dhe pune per shume nxenes maturante dhe si e tille nuk mund te jete niveli i saj me pak se B2. Ruajtja e ketij niveli eshte e rendesishme dhe per vazhdimin e studimeve ne fakultete ku pergatiten mesuesit e ardhshem te gjuheve te huaja, perkthyesit dhe interpretet. Respektimi i parimit te shumegjuhesise eshte nje tjetër aspekt qe duhet marre ne konsiderate per politikat gjuhesore te vendit dhe			
--	---	--	--	--

	ky eshte nje element i rendesishem i mbeshtetur edhe nga filozofia e Ligjit te AL, i cili i ka renditur si te barabarta te gjithë gjuhët e BE. Vendosja e nje raporti te duhur te gjuhes se dyte ka te beje edhe me ndikimin social mbi mesueset qe jane ne tregun e punes te atyre qe tashme kategorizohen si gjuhe te huaja te dyta, te cilet mund te rrezikojne te mbeten pa pune nga menyra se si do te jete organizimi i shtrirjes se gjuheve te huaja ne sistemin parauniversitar. Per kete, sygjerojme se eshte shume e rendesishme qe Ministria te diskutoje me Fakultetin e gjuheve te huaja per formimin e ardhshem te mesuesve te gjuhes se huaj ne menyre qe reformat te mos cojne ne krijimin e shtratit per lindjen e probleme sociale per komunitetin e mesuesve. Eshte e rendesishme te bashkrendohen politikat e ministrise me ato universitare, sidomos per sa i perket ndryshimeve ne programet mesimore qe përgatisin mesuesit e ardhshem jo vetem nga ana permbajtesore, por edhepersa i perket kuotave te programeve te studimit. Nje propozim yni do te ishte per shembull, qe ne kuader te formimit gjate gjithe jetes, mesuesve te gjuheve te huaja te tjera(pervec anglishtes) qe jane aktualisht ne profesion, ata te mbeshteteshin me formim te posacem nga fakulteti i gjuheve te huaja per nje afat te pershtatshem dhe nr kreditesh te dakordesuar qe do mundeson te mesimdhënien prej tyre ne gjuhen e angleze(kjo do zbuste efektin social mbi kete komunitet).			
--	---	--	--	--

	Ne kushtet qe kjo politike permiresohet edhe FGJH mund te orientohet me mire ne programet e mesuesise me dy profile Major dhe minor ne dy gjuhe te huaja, etj, etj. Ideja eshte qe gjuha e huaj e dyte duhet te qendroje e forte dhe te jete pjese e rendesishme e sistemit te edukimit sikunder eshte ne shume vende te Evropes dhe Botes.			
28. Adresimi i fenomenit të emigracionit në strategji	Mendime për kreun “Arsimi i lartë”: Strategjia citon të dhëna nga INSTAT për prirjet e padëshiruara demografike që lidhen me uljen e shpejte të numrit të të rinjve (skenari më rritje të ulët parashikon një ulje me 29,9 % të përqindjes së grupmoshës 1-25 vjec deri 2030!). Ndërkohe është i njohur fakti që është rritur edhe largimi i maturantëve për studime jashtë vendit, strategjia nuk përcakton objektiva të qarta për ndalimin e fenomenit të emigracionit të të rinjve, si dhe rrugët se si sistemi ynë i AL mund të përmbushë pritshmëritë e tyre për studime universitare cilësore. Sistemi i AL është një pasuri e madhe kombëtare. Kësisoj, zbrazja e tij nga studentët dhe kërkuesit e rinj do të kishte pasoja afatgjatë për të ardhmen dhe zhvillimin e vendit. Pyetja është: A mund të jete, kontributi i AL në frenimin e largimit të të rinjve të shkolluar nga vendi, një objektiv kryesor i strategjisë së AL?	KALKSH	Pranohet	U morë parasysh
29. Shfrytëzimi i potenciali akademik të vendit	Strategjia pasqyron pjeserisht potencialet reale të sistemit tonë të AL, sidomos burimet/potencialet njërzore të sistemit. Ajo citon edhe një numër të pedagogëve (nuk dime sa i saktë është) por nuk thotë gjë për nivelin e tyre të kualifikimit, ndërkohë që është e njohur fakti se Shqipëria ka një përqindje, ndër më të lartët në Rajon, të pedagogëve dhe kërkuesve që kanë kryer studimet universitare apo të doktoratës jashtë vendit. Kjo do të thotë se sistemi ka ende një potencial të madh akademik për të afruar mësimdhënie të nivelit nderkombetar dhe	KALKSH	Refuzohet	Nuk është një propozim konkret në lidhje me ndonjë objektiv specifik

	për të kryer kërkime shkencore të nivelit të lartë. Perifrazimi i shpeshte në draft i fenomenit të “plagjiaturës” (edhe pse problem i prekshëm) nuk mund të përdoret për të neglizhuar ekzistencën e një potenciali ende të madh akademik të nivelit nderkombetar në vendin tonë. Në këtë këndvështrim, mendojmë, se zgjidhja nuk duhet të pritët vetëm nga hapja e degëve apo filialeve të universiteteve të huaja, qoftë edhe prestigjioze, në vendin tonë, por, më së pari duhet të shfrytëzohet potenciali akademik që zotëron vendi, i cili, në fakt, është pikërisht një nga investimet e munguara në favor të rinjve dhe të familjeve të tyre. Mbi të gjitha duhet të investohemi në institucionet dhe kapacitetet vendore.			
30. Transparenca	• Transparenca nuk bëhet me portale, megjithatë është një pjesë e saj, por me kërkesë llogaridhëje dhe me bërjen publike të gjithë dokumentacionit të veprimtarisë së një IAL-je. Në këtë drejtim duhet me shumë në lidhje me llogaridhëjen nga ana e IAL-ve, sepse për mua mungesa e përgjegjshmërisë së stafëve akademikë është një çështje e madhme në përmirësimin e cilësive në arsimin e lartë. • Në kuadër të nderkombëtarizimit të arsimit të lartë (4.4.4, faqe 61 ...) mendoj që ka një mungesë të moskuptimit të problematikes së kësaj problemi nuk është vetëm siç analizohet me të drejtë mungesa e aplikimeve por edhe pengesat e shumta administrative-burokratike të vete MARS për të stimuluar diplomatë e përbashkëta apo edhe të dyfishta. Kjo është një çështje që duhet analizuar dhe trajtuar me ligjvënies, atëherë me tëper që nderkombëtarizimi është qëllim në vetvete i arsimit të lartë.	KALKSH	Pranohet	Objektivi C6/1/3
31. Studimet e doktoraturës	Mungesa e referimit të “Studimeve të Doktoratës” në Strategji është jo-inkurajuese për arsimin në vecanti, dhe për zhvillimin në teresi.	KALKSH	Refuzohet	Nuk u morë parasysh

	Një universitet mund të shuhet me shpejtësi, nëse në laboratorët dhe departamentet e tij nuk “gelojnë” doktoratët, të cilët supozohet të jenë motorët e vërtetë të shkencës dhe kërkimit shkencor. Natyrisht vendi ka problem serioze në këtë aspekt. Por strategjia duhet të japë zgjidhje realiste edhe për studimet e doktoratës. Ndryshe, mbi 2,000 asistentë dhe pedagogë të rinj të IAL-ve, do të detyrohen të largohen për studimet e doktoratës jashtë vendit dhe shumica e tyre mund të mos kthehen më. Kjo sepse në çdo vend tjetër ata janë të mirëpritur të punojnë në universitete dhe qendra kërkimore. Natyrisht kjo çështje lidhet ngushtë me përparësinë që do t'i kushtojë strategjia kërkimit shkencor në panoramën e përgjithshme. Gjithashtu, ngërci aq i diskutuar, midis pjesës së një “programi të madh kërkimi”, dhe pastaj hapjes së një “Programi Doktorate”, duhet të zgjidhet, ndoshta duke i klasifikuar këto programe në dy nivele: PhD departamentale dhe PhD (nder-)kombetare. Nderkohe strategjia mund të parashikojë zë të veçantë në Fondin e Shkencës, ku mund të aplikojnë doktorantët në nivel departamentar me projektet e tyre të kërkimit, dhe kështu të ndikohet ngritjen e kapaciteteve të IAL-eve, duke shmangur nepotizmin, favoritizmin dhe politizimin në përzgjedhje. Ndërsa programet (nder-)kombetare duhet të kenë vëmendje dhe asistencë të veçantë, përfshi standarde specifike nëse është e nevojshme, në funksion të interesave dhe politikave më të mëdha të vendit			
32. Brain Gain	Strategjia konstaton se Shqipëria ka ende një numër të pamjaftueshëm pedagogësh dhe kërkuesish shkencor, çka duket edhe në raportin e lartë studente/pedagoge. Edhe pse Shqipëria ka një diasporë të re akademike, proporcionalisht të konsiderueshme në universitetet dhe qendrat e huaja shkencore, strategjia nuk parashikon masa për thithjen e	KALKSH	Pranohet	U morë parasysh

	kërkuesve të rinj që kanë studiuar dhe doktoruar sidomos në universitetet e huaja prestigjioze. Strategjia nuk parashikon masa stimuluese për kthimin dhe thithjen (Brain Gain) e tyre në IAL publike dhe private të vendit, ndërkohë që strategjia konstaton “nepotizëm“ në rekrutimin në IAL publike.			
33. Arsimi i lartë jopublik	Strategjia injoron arsimin e lartë jopublik, qe sherben si alternative per 20% te komunitetit studentor ne vend, dhe ofron projekte dhe shembuj te bashkepunit nderkombetar. Ky sektor thuaje nuk përmendet, edhe pse, sic konstatohet në draft, në vitet e fundit studentët parapëlqejnë të vijojnë studimet në IAL private, për shkak të rritjes së cilësisë në IAL jopublike. Kjo shtyllë e AL shqiptar meriton më shumë vëmendje, mirekuptim dhe mbështetje, perfshi kërkimin shkencor apo projektet e reformimit të programeve të studimit drejt kërkesave të tregut të punës, dhe nder-kombetarizimit. Nderkohe qe vec edukimit alternativ, IAL-et jopublike kane qasje jo-sasiore, operacionale dhe fleksibel, dhe jane aktive ne rrjetezime e projekte europiane, gje qe perputhet teresisht edhe me objektivat e qeverise	KALKSH	Refuzohet	Nuk u morë parasysh
35. Aksesimi në arsimin e lartë	Strategjia konfirmon nderkohe se rritja e buxhetit për AL dhe kërkimin shkencor do të jetë e pakonsiderueshme. Por ajo nuk parashikon rrugë alternative të rritjes së investimit kombëtar për AL, që nenkupton se sektori do të mbetet i nënfinancuar, cka demton objektivat për rritjen e cilësisë të parashikuar në strategji. Nderkohe qe ekzistenca e sektorit jopublik (per shembull) eshte nje nga menytrat e para te mobilizimit te financave alternative brenda vendit ne favour te te rinjve dhe vendit. Se dyti, edhe pse ligji i AL e përmban kredinë studentore, strategjia nuk shprehet per te. Nëse do të aktivizohet kjo, ajo do të ndihmonte shume studentët e familjeve të varfëra apo të	KALKSH		

	‘rretheve’ për të ndjekur studimet universitare jashtë lokacionit të origjinës, sidomos në universitetet e kryeqytetit apo në ato me cilesore dhe të specializuara. Fakti që studentët kanë filluar të marrin kredi në bankat e nivelit të dytë, deshmon se kjo mund të ishte një mbështetje e konsiderueshme për këtë kategori të studentëve. Në këtë kontekst, aktivizimi i kredisë studentore do të përbënte një mobilizim të konsiderueshëm sekondar të resurseve financiare alternative, dhe një mbështetje ekstra në teresi për sistemin e AL të vendit. E thënë ndryshe, kapitalet e “ngrira” të familjeve shqiptare do të investoheshin për të mbështetur shkollimin e fëmijëve të tyre brenda vendit, dhe nuk do të përdorreshin për të mbështetur sistemet e AL të vendeve të tjera, madje edhe të vendeve të pasura të Europës dhe më gjërë. Se fundi, një rritje e cilesisë së arsimit në vend do të hapte një dritare për ndërkombëtarizim edhe të kërkesës për AL dhe Kërkim me studente nga vendet në zhvillim të botes, që janë në kërkim të një oferte cilesore por të përballueshme. Por kjo do të kërkonte mirëkuptim dhe përmirësime ligjore të shpejta nga ana e autoriteteve, përfshi Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Jashtme, dhe Ministrinë e Brendshme, etj.			
36. Formimi praktik	Strategjia përmend nevojën e forcimit të “formimit praktik” të studentëve, ngushtimit të “hendekut teori-praktikë”, dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit të universiteteve me sipërmarrjen private për këtë qëllim. Dihet se programet e studimeve të integruara me praktikën, sidomos “Sistemi Dual”, janë të suksesshme për rritjen e shkallës së punësimit të të diplomuarve. Por strategjia nuk përmend nevojën e rishikimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor për një vlerësim të plotë të formimit praktik të studentëve si dhe të programeve të studimit të integruara me praktikën apo “sistemin	KALKSH		

	dual”. Nderkohe as ligji dhe as VKM-te apo udhëzimet në fuqi, nuk e vlerësojnë me realizëm formimin praktik të studentëve. Në këtë këndvështrim, duhet nënvizuar se ligji 80/2015 e kufizon arsimin e lartë profesional kryesisht në programet post-sekondare 2-vjecare, cka përbën një kufizim serioz për cdo iniciative të IAL-ve për të zhvilluar dhe zbatuar programe të arsimit të lartë “Professional” dhe të tipit “Dual”, jo vetëm në nivelin V, por edhe atë VI (Bachelor) dhe VII (Master Profesional) të Kornizës së Kualifikimeve.			
37. Studimet profesionale	Strategjia nuk shprehet rreth vlerësimit të studimeve profesionale post-sekondare 2-vjecare. Aktualisht ka një mospërputhje midis ligjit të AL (80/2015), që njeh transferimin e krediteve nga niveli V në nivelin VI (shiko edhe skemen perkatese në strategji), ndërkohë që aktet nënligjore e pamundësojnë një gjë të tillë. Por, përtej këtij aspekti formal, por jo të pa rëndësishëm dhe të parashikuar edhe nga standartet e Bolonjës, strategjia mund të shprehet qartë për statusin e këtij niveli të studimeve. Ajo mjaftohet me konsideratën se këto programe janë të shkurtëra dhe mundësojnë daljen më të shpejte të të rinjve në tregun e punës. Ne mendojme se programet në fjalë duhen konsideruar si studime me një orientim të qartë praktik, por që nuk mbyllin, përgjithmonë, të drejtën e të rinjve për të vijuar studimet në arsimin e lartë profesional edhe në nivelin Bachelor (qoftë në programet të tipit Profesional apo Dual). Ndryshe këto programe rrezikojnë të keqkuptohen thjesht si arsim i lartë profesional i “klasit të dytë”, emërtim/reputacion që kritikohet shpesh edhe në studimet ndërkombetare të politikave të arsimit të lartë. Kjo është një tjetër mënyrë që ndihmon të rinjtë e kësaj kategorie sociale të qendrojnë dhe zhvillohen në vend.	KALKSH	Refuzohet	Është adresuar në strategji

38.Llogaridhënia dhe transparenca në IAL	Strategjia citon “Nepotizmin, Grupet e interesit në arsimin e lartë, dhe Favoritizmin” në rekrutimin dhe promovimin e personelit akademik dhe jo-akademik në institucionet e arsimit të lartë, si risqe që dëmtojnë meritokracinë dhe ndikojnë negativisht në cilësinë e mësimin dhe kërkimit. Strategjia shprehet se korniza rregullatore e arsimit të lartë duhet të promovojë llogaridhënie dhe transparencë, ndërsa është e domosdoshme që të rriten kapacitetet e organeve kolegjiale të IAL-ve publike për të siguruar respektimin e parimeve të integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhënies. Kjo rrezikon të mbetet thjeshtë një deklaratë në strategji, nëse nuk parashikohen masa ose reforma konkrete, apo përmirësime në kuadrin ligjor, për të parandaluar këto fenomene në veteqeverisjen dhe menaxhimin e universiteteve.	KALKSH	Pranohet	U rishikua për nga ana terminologjike pjesa e analizës
39. Kredia studentore	Strategjia konfirmon nderkohe se rritja e buxhetit për AL dhe kërkimin shkencor do të jetë e pakonsiderueshme. Por ajo nuk parashikon rrugë alternative të rritjes së investimit kombëtar për AL, që nenkupton se sektori do të mbetet i nënfinancuar, cka demton objektivat për rritjen e cilësisë të parashikuar në strategji. Nderkohe që ekzistenca e sektorit jopublik (për shembull) është një nga menyrat e para të mobilizimit të financave alternative brenda vendit në favour të të rinjve dhe vendit. Se dyti, edhe pse ligji i AL e përmban kredinë studentore, strategjia nuk shprehet për të. Nëse do të aktivizohet kjo, ajo do të ndihmonte shumë studentët e familjeve të varfëra apo të ‘rretheve’ për të ndjekur studimet universitare jashtë lokacionit të origjines, sidomos në universitetet e kryeqytetit apo në ato me cilesore dhe të specializuara. Fakti që studentët kanë filluar të marrin kredi në bankat e nivelit të dytë, deshmon se kjo mund të ishte një mbështetje e konsiderueshme për këtë kategori të studentëve.	KALKSH	Refuzohet	Nuk u morë parasysh

	Në këtë kontekst, aktivizimi i kredisë studentore do të përbënte një mobilizim të konsiderueshëm sekondar të resurseve financiare alternative, dhe një mbështetje ekstra në teresi për sistemin e AL të vendit. E thënë ndryshe, kapitalet e “ngrira” të familjeve shqiptare do të investoheshin për të mbështetur shkollimin e fëmijëve të tyre brenda vendit, dhe nuk do të përdorreshin për të mbështetur sistemet e AL të vendeve të tjera, madje edhe të vendeve të pasura të Europës dhe më gjërë. Se fundi, një rritje e cilësive të arsimit në vend do të hapte një dritare për ndërkombëtarizim edhe të kërkesës për AL dhe Kërkim me studente nga vendet në zhvillim të botes, që janë në kërkim të një oferte cilësore por të përballueshme. Por kjo do të kërkonte mirëkuptim dhe përmirësime ligjore të shpejta nga ana e autoriteteve, përfshi Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Jashtme, dhe Ministrinë e Brendshme, etj.			
40. Ndërkombëtarizimi dhe programet e përbashkëta	1. Në Objektivin Specific C6 “Nërkombëtarizimi & integrimi në EHEA” a. T’i jepet me shumë përparësi pikës 2 “Ngritja e zyrave të projekteve”. Këto zyra të jenë në universitetet me cilësore, të fillojë si pilot në 5 dhe të shtohet deri në 10 në vend. Vetëm universitetet me cilësore. Mund të punojmë në një udhëzim krijimi të këtyre zyrave. I shoh të ngarkuara për të aplikuar për projekte ndërkombëtare, për projekte me industrinë, që merren me vlerësimin e arsimit të lartë dhe kërkimit. Kjo është pika me rëndësi të këtij Objektivi. Dhe e perseris, t’u jepet me të mirëve. Është një ndihmë institucionale dhe jo personale. b. T’i jepet përparësi pikës 3 “Programe të ndërkombëtarezuara në Shqipëri”. Kjo bëhet me ndihmën e zyrave të lartë, plus me lëvizshmëri të ardhjen e pedagogëve të diasporës për një kohë të caktuar, apo edhe pedagogëve të huaj që akademikët tani kanë krijuar kontakte gjatë këtyre 20 viteve që kanë shkuar nëpër konferenca jashtë, etj. Kjo pikë është	KALKSH		Është adresuar në strategji.

	me afatmesem dhe nuk mund te mendojme se do e arrijme ne 4 vjet, por mund te filloje ndihma per te. c. Ne rradhe te trete, te vendoset pika 1 “Programe Studimi te Perbashketa”. Keto programe duan shume “netëorking” dhe shume pune individuale ndermjet pedagogeve shqiptare (qe tashme kane kontakte jashte), dhe ndermejt departamentave dhe IAL-ve. Mbase kjo pike eshte pak e ngjashme me piken 3. d. Te shikohet me vemendje nese duam te vazhdojme te paguam levizshmerine –mobilitetin e stafit!! Cjane keto bursa te reja qe paguaka shteti???? Shteti po paguan ne forme strukture HorizonEurope dhe Erazmus+. Nese stafi yne universitare do te levize e te trajnohet, le te fitoje projekte te Erasmus+. Donatoreve te huaj duhet t’i kerkohet leke, jo me per udhetime jashte shtetit, por per te forcuar institucionet dhe per t’i nderkombetarizuar ato. e. Te mbahet gjithmone vemendja tek pjesemarrja sa me shume te jete e mundur ne EHEA. Kjo pjesemarrje duhet te jete jo vetem politike por edhe institucionale – nga vete IALet!! Sa me shume vizibilitet, sa me shume aplikime per programet europiane!! Nuk e ben leku cilesine e aplikimeve, e bejne njerezit e motivuar dhe profesionale!!! Dhe nga qeveria duhet te marre fund motivimi per trajnime jashte shtetit (pika qe jap me pare).			
--	---	--	--	--

41. Arsimi i specializuar	Fëmijë të spektrit autik ligjërisht mbështeten deri në arsimin 9 vjecar me mësues të specializuar, në këtë strategji të mund të kemi dhe një parashikim, si mundet që të shoqërohen edhe gjimnazet me mësuesit e specializuar për fëmijët me aftësi ndryshe apo me spektrin e autizmit.	Bashkisë Durrës	Refuzohet	E kemi te strategjia te A.1.3 Nuk ka diferencim për këtë, mësuesit ndihmës janë deri
---------------------------	---	-----------------	-----------	---

				ne AML jo deri ne AMU
42. Artet dhe zejet në shkolla	1. Të shihet më me interes në drejtim të arteve dhe të zejeve dhe në bazë të krahinave. 2. Rritja e zhvillimit të kabineteve dhe të praktikës në shkollat profesionale që kanë të bëjnë me artin dhe zejet.	Prefekt i Qarkut Durrës	Refuzohet	Në lidhje me rekomandimin është tashmë i përfshirë në strategji. Në draft-strategji është përcaktuar "Produkti A3.6. Të mësuarit e zejeve dhe të arteve në arsimin e mesëm të lartë në kuadrin e kurrikulës me zgjedhje". Modulet kurrikulare do t'i japin hapësirë dhe kontekstit lokal të zbatimit.
43. Bullizmi në shkolla	Hartimi I specifikave të vecanta për të goditur fenomemin e bullizmit nëpër shkolla.	Nxënës, gjimnazi "Naim Frashëri"	Pranohet	Është reflektuar në objektivin A.1.7 çështja e bullizmit
44. Pjesëmarrja në olimpiada	1. Pjesëmarrja e nxënësve të shkollave publike në olimpiadat ndërkombëtare.	Nxënës, gjimnazi "Naim Frashëri"	Refuzohet	Nuk është çështje për tu adresuar në strategji.
45. Unifikimi i teksteve mësimore.	Unifikimi I teksteve mësimore, përshtatja dhe redaktimi I tyre në shqip.	Nxënës, gjimnazi "Qemal Stafa", Tiranë	Refuzohet	Tekstet shkollore janë të përshtatura dhe të redaktuara. Ligji për arsimin

				parauniversitar, neni 47 për tekstet shkollore përcakton se tekstet për nxënësit janë alternative. Numri i alternativave të teksteve shkollore kufizohet në jo më shumë se tre alternativa për çdo lëndë ose fushë të të nxënit.
46. Fleksibiliteti i SKA	Strategjia e arsimit të jetë më fleksibël dhe me fonde të hapura, e adaptueshme edhe për nxënësit e brezave në vijim	Nxënës, gjimnazi "Qemal Stafa", Tiranë	Pranohet pjesërisht	Strategjia nuk është e ngurte, është fleksibel. Por mund të ketë një fleksibilitet në planin e veprimit pas një vlerësimi 2 vjeçar që do bëjme
47. Arsimi parashkollor	"Një korrigjim sepse në arsimin parashkollor mbase duhet të themi jo klasë përgatitore por grupmoshë 5- 6 vjec ose të themi në arsim parashkollor sepse ajo klasa përgatitore për neve tingëllon pak sepse janë disa klasa të vecanta nëpër territirre ku nuk është e mundur të zhvillohet shërbimi në arsimin parashkollor por që janë fëmijë të grupmoshave të ndryshme që janë brenda një shkolle. Ne themi që kjo gjë të shkojë në të gjithë sistemin të flitet për arsim parashkollor dhe ta heqim atë termin klasë përgatitore."	DPAP	Pranohet	

48. Ndërlidhja me tregun e punës	Përshtatja dhe njohja e studentëve me nevojat e tregut të punës në rajon dhe më gjerë.	Përfaqësues i prindërve të shkollës "Gjergj Kastrioti", Durrës	Refuzohet	Është adresuar në draftin e strategjisë ndërlidhja e arsimit me tregun e punës dhe arsimit me tregun e punës .
49. Shkollat, qendër komunitare	Të rritet numri i shkollave qendër komunitare	Mësues gjimnazi Perikli Ikonomi, Fier	Pranohet	Adresohet në objektivin A1.7.
50. Mësuesit ndihmës	Mësues ndihmës të jenë të specializuar dhe të licensohen	Mësues gjimnazi Perikli Ikonomi, Fier	Pranohet	Adresohet në objektivin A1.3.
51. Oficerët e sigurisë në shkolla	Duhet parë më me fokus shtimi i punonjësve të sigurisë në shkolla, ndërsa te pjesa e menaxhimit struktura arsimore lokale sa ka në dorë? (faqja 114 , tabela 19 që ka oficerët e sigurisë, shtimin e buxhetit)	Prind nxënësi	Pranohet	Adresohet te A1.7
52. Ndërkombatërizimi i arsimit të lartë	Të përfshihen vizion, ndërkombatërizimi i arsimit të lartë edhe pjesa tjetër që janë objektivat e qëndrueshëm, pika 7 edukimi për zhvillim të qëndrueshëm e qytetarit global, kjo qytetari global, idea të bashkohet me ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë por edhe edukimi për një zhvillim të qëndrueshëm. Vizioni përmbledhet në tre fjali dhe nuk mund të shtohet më shumë por ato elementët e tjerë që janë aty, foci i demokracisë, integrimi europian mund të bashkohen. Një element tjetër që është element teknik që pashë në strategji është një term i përdorur	Përfaqësues i institucionit të perfektit qarku Fier	Pranohet pjesërisht	Një pjesë e sugjerimeve të bëra janë të përfshira në objektiva të veçantë të strategjisë. Termi pushteti vendor me qeverisje vendore.

	pushteti vendor, është term i kaluar, aktualisht përdoret qeverisje vendore. Dhe tjetra është që me keqardhje e them këtu po diskutohet vetëm arsimi parauniversitar, Fieri ka ngelur pa një institucion të arsimit të lartë që është një qark me potencial të madh.			
53. Nxënësit me aftësi të kufizuara	Kisha dy sugjerime rreth aftësisë së kufizuar, e para ka të bëjë me vendimin për fëmijët nëse është për në shkollë apo jo, ti lihet komisionit të ZA, dhe nëse mundet që te ulet numri I nxënësve që ne të japim shërbimin në klasën speciale	Anëtare komisioni për fëmijët me AK, ZVAP Fier	Refuzohet	Komisioni i ZA jep rekomandim e kemi të parashikuar ne akte ligjore dhe udhezimin për mësuesin ndihmës. Vendimin e jep vetë prindi.
54. Trajtimi i pagës së shërbimit psiko social	Ne kërkojmë që të paktën të trajtohem si mësuesit në lidhje me pagën sepse vështirësinë e punës e kemi njësoj dhe numrin e nxënësve që kemi aktualisht e kemi më të lartë se sa vetë mësuesit që japin mësim në shkolla.		Refuzohet	Drejtorja e buxhetit MASR i ka derguar shkresë MFE për trajtimin e punonjësve social por është refuzuar
55. Arsimi i minoriteteve	Një mini strategji duhet bërë edhe për arsimin e minoriteteve sepse gjendemi përpara faktit, unë si drejtor dhe drejtori rajonale se në qoftëse nuk ekziston një rregullim ligjor ne nuk mund të veprojmë sic ishte tani rasti i fundit i tesimit të VANAF që ishte në gjuhën shqipe ndërkohë që 80% të mësimit nxënësit e zhvillojnë në gjuhën amtare të minoritetit. Ligji i përgjithshëm nr 69 është dhe 96 që ka të bëjë me arsimin e minoriteteve, këto të dyja nuk kanë ndërthurje me njëra tjetrën sepse nuk ka akte nënligjore në zbatim të ligjit të minoriteteve dhe në këtë drejtim,	ZVAP Finiq-Dropull	Refuzohet	Në shkollat e pakicave kombëtare në përfundim të klasës së pestë, mund të jepet provim edhe gjuha amtare (e organizon shkolla). Nuk mendoj se duhet

	në raport me gjuhën ose plani mësimor dhe shumë gjëra teknike që janë që duhen zgjidhur nuk mund ti bazosh në ligj nëse nuk dalin këto dhe shumë herë ndodhemi përpara faktit që ne bëhemi shumëkërkues por ndodhemi para mangësisë ligjore dhe kjo mangësi ligjore në këtë strategji duhet rregulluar. Ky është fakti i parë. Fakti i dytë që duhet të vlerësohet është që kjo mënyrë e shkollës dy gjuhësë nuk është e gjitha në gjuhën amtare të minoritetit.			hequr gjuha shqipe, pasi është gjuhë zyrtare dhe numri i orëve të gjuhës shqipe në planin mësimor është i konsiderueshëm. Te gjitha janë të rregulluara me akte normative. Provimin e klases se 9 e ka detyrim, gjuha që studiojne eshte 80 % me gjuhën e tyre etj.
56. Arsimi parauniversitar	Arsimi parauniversitar duhet të ketë një strategji të veçantë sipas rajoneve të cilat duhet të parashikohet te strategjia në mënyrë të atillë që ti paraprijmë problematikave që janë dy: rënia e numrit të fëmijëve edhe nevoja për më shumë vëmendje të fëmijët me aftësi të ndryshe edhe shërbimi psiko-social.	DRAP "Lezhë"	Refuzohet	Strategji për arsimin do të përfshijë arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë. Përsa u përket problematikave të cituara theksojmë se ato janë të adresuara në SKA.
57. Koment në lidhje me kurrikulat	Mbështetje edhe një suport shumë më të madh për fëmijët me aftësi të kufizuara. Vlerësoj pjesën e arsimit parashkollor që është përfshirë te draft-strategjia, veçanërisht loja është e rëndësishme, të mësuarit më tepër nëpërmjet lojës. Ti kushtohet më tepër rëndësi në sistemin tonë arsimor por edhe atë universitar lëndës se drejtshkrimit. Një tjetër problem gjithmonë	Bashkia "Kukës"	Refuzohet	Në lidhje me rekomandimin "Duhet futur në kurrikul një lëndë që të flitet më tepër për riprodhimin

	është në rënie numri i nxënësve. Çfarë politikash do ndiqen? Sigurisht, ka shumë mënyra por duke duhen parë, duhen studiuar mirë aty ku ndërtohen shkolla. Duhet parë edhe jetëgjatësia sepse ne mund të ndërtojmë një godinë por vitet që vinë mund të jetë e boshatisur. Shtimi i trajnimeve profesionale për mësuesit, jo vetëm te pjesa e formimit profesional tek dega dhe profili, por duhet më shumë dimensional duke filluar që nga menaxhimi, etj. Duhet futur në kurrikul një lëndë që të flitet më tepër për riprodhimin seksual.			seksual"- Refuzohet Edukimi seksual trajtohet i integruar në lëndën e biologjisë në arsimin bazë dhe të mesëm të lartë, si dhe përmes një moduli të vecantë në kurrikulën me zgjedhje në gjimnaz.
58. Tekstet shkollore	Do doja që të vendosnim fokusin edhe në një pikë tjetër që personalisht për mua si nxënëse është e rëndësishme që janë pikërisht librat që përdoren. Pandemia ka nxjerrë mangësi në librat që janë në qarkullim në sistemin tonë arsimor dhe shpesh mësuesit janë detyruar që të bëjnë një përshtatje ndërmjet librave dhe programit që ekziston. Edhe në fakt kjo për ne si nxënës është shumë konfuzuese, do të doja që t'i jepet rëndësi kësaj çështje.	Nxënëse Gjimnazi "28 Nëntori"	Refuzohet	Tekstet shkollore janë të përshtatura dhe të redaktuara. Ligji për arsimin parauniversitar, neni 47 për tekstet shkollore përcakton se tekstet për

				nxënësit janë alternative. Numri i alternativave të teksteve shkollore kufizohet në jo më shumë se tre alternativa për çdo lëndë ose fushë të të nxënës.
59. Shkolla e drejtorëve	Te kjo strategji është diskutuar në lidhje me shkollën e drejtorave, por do të sugjeroja që të shikohet mundësia e përsheptimit të drejtorëve të procesit për ata që kanë dëshirë të regjistrohen në këtë shkollë dhe nga ana tjetër a do të ishte e mundur që të hapet dhe një degë tjetër në Shkodër në këtë mënyrë do të ndihmonit dhe veriun. Nga ana tjetër do gjykoja dhe do sugjeroja që ka ardhur momenti që sot të flitet për statusin e mësuesit. Është momenti që duhet të ulemi dhe duhet të mendojmë se si të do të konceptohet se si realisht do të konturohet elementi kryesor që lidhet me statusin e mësuesit. Dhe e fundit do mendoja ti jepnim prioritet bibliotekave shkollore.	Shkolla e Bashkuar "Gjovalin Gjoshi"	Refuzohet	Statusi i mësuesit është pjesë e strategjisë sepse lidhet me sistemin e karrieres
59.Paisja me libra dhe transporti	E para shoh që duhet të ndryshojë është pajisja e nxënësve që fillojnë me libra të reja. Ka dy vjet që librat po qarkullojnë nga viti në vit dhe e shoh të pavend për ciklin pasardhës që të mbajnë librat e vjetër dhe të punojnë me to. Një pikë tjetër që nuk u trajtua është edhe problemi i transportit të fëmijëve, të nxënësve dhe mësuesve të cilët edhe te ajo pjesë e kësaj strategjie dihet që do ndikojnë në rritjen e cilësisë në arsim. Një pikë tjetër që e shoh me vend është se institucionet e reja që janë krijuar ka dy	DRAP "Lezhë"		

	vjet që ne nuk kemi marrë asnjë pajisje të re për funksionimin e zyrave			
60. Dhuna në shkolla dhe abuzimet seksuale	Dhuna në shkolla dhe abuzimet seksuale, bullizmi janë pjesë në arsimin tonë parauniversitar. Do të kisha dashur që të rishikohen paksa kurrikulat e shkollave në mënyrë që etika e të sjellurit të futet në klasat e para fillore dhe realisht në ato grupmosha të vogla ku fillon dhe formimi i fëmijëve madje të jenë pjesë edhe e shkollave si qendra komunitare, por më së shumti do kisha dashur që të ishte pjesë e këtyre kurrikulave në mësimdhënie edhe gjinia mashkullore.	Këshillit rajonal të Prindërve DRAP "Lezhë"	Refuzohet	Janë adresuar në strategji fenomeni i bulizmit dhe dhunës.
61. Shkollat Komunitare	Shkollat Komunitare zhvillimi i tyre është domosdoshmëri. Pikë tjetër është pajisja e shkollave me laboratore sepse kjo do të bëjë lidhjen midis teorisë dhe praktikës në zhvillimin e dijeve tek nxënësit. Pikë tjetër e rëndësishme është futja e "vullnetarizmit". Pjesa e Infrastrukturës sidomos për nxënësit që kanë nevojë.	Perfekte Qarku "Shkodër"	Refuzohet	Është adresuar në strategji.
62. Arsimi profesional	Një trend në rritje i shkollave të arsimit profesional, besoj se është domosdoshmëri në arsimin e sotëm.	Prefekti Qarku "Lezhë"	Refuzohet	Nuk është në fushën e përgjegjësisë së MAS
63. Emërimet e mësuesve në arsimin parashkollor	Emërimet në arsimin parashkollor duhet të qëndrojnë tek arsimi dhe jo t'i kalojnë kryetarit të Bashkisë sepse për të kjo është një punë e lodhshme. Tjetër gjë që duhet ta shoh edhe Ministria e Arsimit është shtimi i mësuesëve ndihmës edhe në kopshte, është e domosdoshme.	Bashkia Rrethi "Kurbini"	Refuzohet	Për arsimin parashkollor të gjitha kompetencat i ka qeverisja vendore Emërimet i ben pushteti vendor, i emërojnë ato duke përdorur portalin.

64.Reduktimi i braktisjes së shkollës	Reduktimi i braktisjes shkollore kryesisht i komunitetet rom dhe egjiptian	drejtuese pranë SHSSH në Korçë	Refuzohet	Është adresuar në strategji
65. Fëmijët me aftësi të kufizuara	Fokusi te gjithëpërfshirja, theksin te fëmijët me aftësi të kufizuar.		Refuzohet	Është adresuar në strategji
66.TIK që në klasë të parë	Futja e TIK që nga klasa e parë dhe vëmendje ndaj laboratorëve kompjuterik për të mos patur mungesa kompjuterash në zonat rurale.	drejtuese pranë SHSSH në Korçë	Pranohet pjesërisht	Do bejme nje vleresim për ta përfshir TIK në një afat tjetër kohor jo këtë vit
	Futja e elementit të TIK në klasën e parë, në mënyrë kreative duke marrë eksperiencat më të mira të kohës. Fëmijët në atë moshë rekomandohet që duhet të mësojnë nëpërmjet kreativitetit.	Kryetari i Bashkisë Korçë		
67. Zhvillimi profesional të mësuesve.	Sugjerohet krijimi i një bashkëpunim të fortë me ASCAP ku mund të krijohet brenda DRAP një bërthamë trajnerësh, të cilët do të jenë të aftë të trajnojnë profesionalisht punonjësit e zyrave dhe të jenë në dispozicion të zhvillimit profesional të mësuesve.	DRAP Korçë	Refuzohet	Është e përcaktuar në draft-strategji. Forcimi i kapaciteteve njerëzore në sektorët e kurrikulës në nivel të DRAP-ve dhe ZVAP-ve, në funksion të mbështetjes së shkollave për zbatimin e kurrikulës me kompetenca. Sipas organikës, DPAP-ja duhet të ketë 261 specialistë në sektorët e monitorimit të

				kurrikulës dhe zhvillimit profesional të nivelit qendror, rajonal dhe vendor: 239 specialistë në 52 ZVAP-të, 16 specialistë në katër DRAP-të dhe 6 në Drejtorinë Qendrore të DPAP-së. ASCAP-i do të ofrojë mbështetje të vazhduar për zhvillimin e kapaciteteve të specialistëve në sektorët e kurrikulës në DRAP-e dhe ZVAP-e, si dhe këshillime të vazhdueshme për DPAP-në në mënyrë që të mund të ofrojnë mbështetje efektive për shkollat për zbatimin e kurrikulës me kompetenca.
--	--	--	--	---

68. Shkollat e bashkuara	Minimizimi i numrit të shkollave të bashkuara, për shkak të problematikave që sjellin, pasi ka fëmijë nga të gjitha grupmoshat.	DRAP Korçë	Refuzohet	Është adresuar në strategji
69. Shkollat speciale	Bashkëpunim më i ngushtë i pushtetit vendor (AK kompetencë e bashkive) me MASR për kthimin e shkollave speciale si qendra burimore për nxënësit me AK.	Bashkia Korçë	Refuzohet	Është adresuar në strategji
70. Arsimi parashkollor	Arsimi parashkollor duhet të jetë më vete jo brenda ambjenteve të shkollave pasi krijon probleme, kjo lidhur dhe me drejtorët e shkollave të cilët skanë pse të kenë kompetencë mbi ta për sa kohë është bashkia që ka në ngarkim arsimin parashkollor.	Bashkia Korçë	Refuzohet	Nuk ka lidhje me strategjinë sepsë është çështje infrastrukture. Pushteti vendor dhe zyrat arsimore duhet të bashkëpunojnë për ta zgjidhur këtë problem.
71. Trajnimet/Kreditet	Rrjetet profesionale të përfshijnë trajnime për lëndë të ndryshme si dhe të ofrojnë kredite falas për mësuesit.	Mësuese e gjuhës në shkollën 9 vjeçare “Naum Veqilarxhi”	Refuzohet	Rrjetet profesionale nuk mund të ofrojnë kredite pasi nuk janë etnitete të akredituara. Është pjesë e strategjisë fuqizimi i rrjeteve profesionale
72. Lëndë në lidhje me edukimin dhe shëndetin	Përfshirjen e disa lëndëve që lidhen me edukimi për shëndetin dhe mbrojtja e shëndetit që në klasat e arsimit fillor.	ZVAP Gramsh	Refuzohet	Njohuritë për shëndetin në arsimin fillor përfshihen në programet mësimore të lëndës Dituri natyre. Gjithashtu si pjesë e

				kurrikulës me zgjedhje shkollat zhvillojnë veprimtari për shëndetin. Dhe në përvojat e huaja përgjithësisht edukimi për shëndetin zhvillohet i integruar përmes lëndëve, dhe jo si lëndë e vecantë.
73. Lëndë në lidhje me mjedisin	Mjedisi duhet jete një lëndë e përfshirë në kurrikulën bazë që në klasat më të ulta	ZVAP Gramsh	Refuzohet	Në kurrikulën me bazë kompetencat, Mjedisi është një tematikë e përfshirë në lëndët e fushës Shoqëria dhe mjedisi si në arsimin bazë dhe në arsimin e mesëm të lartë. Përgjithësisht mjedisi zhvillohet në formë të integruar përmes lëndëve gjeografi, qytetari, fizikë, biologji etj. Në kurrikulën me zgjedhje gjithashtu shkollat zhvillojnë veprimtari/module

				për mjedisin. Mjedisi është cështje kroskurrikulare që mund të trajtohet në tema të vecanta në lëndë të ndryshme. Dhe në përvojat e huaja përgjithësisht mjedisi trajtohet i integruar përmes lëndëve, dhe si cështje kroskurrikulare.
74. Arsimi professional	Shtrirja më tepër e arsimit profesional, çdo bashki duhet të ketë një klasë të këtij arsimi e përshtatur me rrethanat e vetë bashkisë.	ZVAP Gramsh	Refuzohet	Arsimi profesional nuk është në fushën e përgjegjësisë shtetërore të MAS
75. Inspektimi në shkolla	Rivendosja e inspektimit dhe monitorimit në shkolla të punës së mësuesve pasi ka krijuar një precedentë dhe duket paksa e cënuar.	Drejtor i gjimnazit "Ymer Dishnica"	Refuzohet	Ky rekomandim refuzohet, pasi ne draftstrategji, ne pjesën "Menaxhimi i sigurimit të cilësive" është parashikuar rritja e numrit të vlerësimeve të jashtme, nëpërmjet rritjes së numrit të kapaciteteve vlerësuese. Për më tepër, në një

				marrëveshje me Shkollën së Drejtoreve dhe ASCAP-it është parashikuar krijimi i rrjetit të vlerësuesve të IAP-ve, te certifikuar, të cilët do t'u vijnë në ndihmë institucioneve vlerësuese, duke i bashkangjitur në grupet e vlerësimit/inspektimit, sipas nevojave.
76. Pajisjen e shkollave me kompjutera.	Pajisjen e shkollave me kompjutera. Mësuesit e TIK të jenë specialist të mirëfilltë në mënyrë që të ketë një zhvillim të mirë të kompetencës digjitale.	Drejtor i gjimnazit "Ymer Dishnica"	Refuzohet	Është adresuar A4.1
77. Numri I nxënësve në klasa	Të rishikohet normativa që përcakton kriteret për hapjen e klasave paralele lidhur me numrin e nxënësve, pasi ka shkolla ku ka rënë numri i nxënësve.	Drejtor i gjimnazit "Ymer Dishnica"	Refuzohet	Është adresuar në strategji
78. Norma mësimore	Norma mësimore e një mësuesi të rishikohet, smund të hyj një mësues matematike të japi histori etj.	Drejtor i gjimnazit "Ymer Dishnica"	Refuzohet	Kjo lidhet me mësues që punojnë në profilin përkatës dhe është e adresuar në strategji.
79. Arsimi I lartë dhe kërkimi shkencor	Formatet për hartimin e këtyre dokumentave të jenë në përputhje me VKM-në 290 për sistemin për krijimin e të dhënave shtetërore të sistemit IPSIS. Fakti i kostimit të planit të veprimit	Kryeministria	Pranohet	

	i cili teorikisht duhet të jetë me 0% vakum financimi deri në vitin 2024 sigurisht besoj dokumentat e kanë të parashikuara një mbulim financiar qoftë nga PBA qoftë nga donatorë të ndryshëm. Cdo institucion, çdo masë e parashikuar në këto dokumenta duhet të ketë një institucion lider jo disa njëherazi sepse vet sistemi është i konfiguruar në mënyrë të tillë që nuk përcakton dot një numër më shumë se një institucion për një masë dhe mendoj që kjo duhet mbajtur në konsideratë në fakt nga grupi i punës për ta përcaktuar qartë këtë pjesë. Mendoj që drafti i strategjisë së Arsimit duhet të përmbajë edhe kërkimin shkencor të paktën si qëllim politikash apo disa objektiva specifike. E para sepse arsimit i lartë nuk mendoj se mund të konsiderohet i shkëputur kërkimi shkencor dhe e dyta sepse dhe vet Ministria e Arsimit ka një program të dedikuar buxhetor për kërkimin shkencor dhe gjithashtu dhe Pakti për Universitetin e ka një komponent të vetin përmirësimit të kërkimit shkencor dhe është e rëndësishme që të merrret në fokus nga strategjia e sektorit që është strategjia e arsimit dhe jo vetëm për këtë arsye po se dhe sistemi IPSIS në mënyrën se si është konfiguruar dhe konceptuar. duhet të rishikohet strategjia e shkencës e cila prite të rinovohet nuk e di kur ekzaktësisht, do duhet që të ekzistojë lidhja parent-child në sistem në mënyrë që të bëhet aplodimi i duhur jo vetëm për këtë arsye, besoj që arsyeja e parë dhe më e rëndësishme është fakti që kërkimi shkencor s'mund të shihet i shkëputur do të jetë një pjesë integrale e gjithë dokumentit strategjik për arsimin. Duhet shumë më tepër punë të bëhet për sa i përket bullizmit dhe kjo ndikon edhe në braktisje të shkollave dhe këtë unë do ta lidhja dhe me shërbimet psikosociale që duhet të ofrohen në shkollat tona. Një sugjerim që do të vinte nga ana jonë që punonjësit që punojnë në institucionet arsimore a do të duhet që në një farë mënyre për ti parë nqs janë të aftë për të punuar me			
--	--	--	--	--

	fëmijët kjo edhe për të shmangur atë që unë përmenda pak më herët për sa i përket abuzimeve seksuale që kanë ndodhur në sistemet tona arsimore. Nëse në tekstin e Historisë ku në Luftën e Dytë Botërore përmenden vetëm Hebrenjtë, të përmenden, përfshihen edhe Romët dhe në lëndën e Sociologjisë të futet termi i Antixhipsizmin			
80. Tekstet për fëmijët Romë	Një sugjerim që do lidhej me këto pjesë do ishte tekste falas në shkollat e mesme për nxënësit romë dhe egjiptianë dhe një bursë diku te 5 mijë lekë të reja në muaj për të ndihmuar në një farë mënyre në shkolla. Edhe një sugjerim tjetër që do lidhet me çështjen e arsimit për sa i përket atyre studentëve të cilët të ardhurat i kanë familjare mujore janë shumë të pakta dhe ndërkohë e studimit është nga Korça e drejtë e studimit I del në Tiranë çështja e konviktit në një familje rome me të ardhura po themi 26 mijë lekë në muaj është e vështirë për të përballuar kostot e konviktit. Mendoj që nga ana e qeverisë duhet bërë diçka për të ndihmuar këta studenë që vinë nga rrethet për sa i përket akomodimit në konvikte në Tiranë. Po ashtu një sugjerim tjetër do ishte të shqyrtojnë kuotat, u dha autorësia e universiteteve. Kjo solli shumë probleme për sa i përket regjistrimit të studentëve në universitete dhe për sa i përket po ashtu edhe përfitimit nga tarifat.	MSHMS	Refuzohet	Vendimi nr. 486, datë 17.6.2020 “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, në shkronjën “e” pika 6.1 parashikon se nxënësit kategorisë rome dhe egjiptiane përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin në masën 100% të çmimit të teksteve shkollore janë
81. Shërbimi psikosocial në shkolla	Një nga aspektet që dhe ne si delegacion i vëmë rëndësi lidhet me aspektin e arsimit gjithëpërfshirës dhe kjo si pjesë e programit të përfshirjes sociale. është parashikuar mbështetje financiare dhe kemi kaluar në proces të gjatë me MASR lidhur		Refuzohet	Është e perfshirë kudo në strategji.

	me dizenjimin këtij komponenti. Së dyti, në fokus është shërbimi psikosocial në shkolla. janë bërë hapa pozitivë por ende shërbimi psikosocial nuk është i plotësuar me burime njerëzore dhe profesionistë për të përballuar problemet e reja me të cilat hasen fëmijët apo prindërit. Trajnimi, monitorimi i këtij shërbimi, vlerësimi i efektivitetit i të gjithë politikës që MASR ka raportuar dhe së treti pjesa e fëmijërisë së hershme nuk ka qenë në këtë strategji pasi është cikli i parë i jetës. Aspekti politik i kësaj është i rëndësishëm. Mund të ishte MASR ajo që mund ta përfshinte.			
82.Periudha post-covid	Kjo strategji duhet të parashikojë periudhën post-covid në mënyrë që sistemi i arsimit në Shqipëri të ndihmojë në pjesën e të nxënësve që fëmijët të rikuperojnë disa nga njohuritë për këtë periudhë. Ajo që nuk pashë në strategji është edhe programi "Bëjmë detyrat e shtëpisë i cili ka qenë i pilotuar nga MASR. Ky program mund të ishte akoma me vlerë sepse ndihmojmë nxënësit. Përfshirja e një klase gjinore e strategjisë, indeksi i gjithëpërfshirjes, duhet një bashkëpunim më i madh midis MASR dhe MSHMS		Pranohet pjesërisht	Për periudhën e kaluar është e realizuar, nga masat e marra nga ASCAP. Për periudhën post covid duhet parë nëse ka plane afatgjatë për mirëqënien e nxënësve, që të hynë në ritmin e mëparshëm. Për atë që do të bëjë ASCAP për fillimin e vitit shkollor është përfshirë, në strategji por nëse bëhet fjalë për plane më afatgjata duhet parë më gjërë.

				Bëjmë detyrat e shtëpisë duhet fuqizuar. Lidhur me pikën e fundit të pjesa e gjithëpërfshirjes mund të ndalemi diku, me veprimtari ose produkte por është e paqartë se çfarë ka dashur të thotë personi.
83. Të drejtat e fëmijëve	1. Strategjisë i mungon sfida ndaj vetvetes. 2. Në krahasim me strategjinë e mëparshme në draft strategjinë e re mungojnë programet, pra janë të njëjtat programe që zbatohen sot në shkolla. Cilat janë programet e reja që duhet të nxit MASR? Cila ka qenë vlera e programeve ekszistuese dhe çfarë kanë arritur ato? Mungon një vlerësim i plot i tyre. 3. Sipas përvojave të vendeve anëtare të BE-se, në faqen e parë të strategjisë nuk vendosen logo të organizatave jofitimprurëse (si psh. logo e UNICEF) përveç logos së MASR. 4. Strategjisë i mungon vizioni afatgjatë, pra çfarë rezultatesh do arrihen me nxënësit, adoleshentë dhe studentët për 20 vitet e ardhshme. 5. Lidhur me faktorët e riskut, shkollat sot përballen me disa faktorë të cilat në shumicën e rasteve janë faktorë të jashtëm por edhe faktor të brendshëm, si çështja e dhunës e cila është kthyer në një çështje prioritare për të drejtat e fëmijëve në Shqipëri që shfaqet në dy forma: bullizmi dhe dhuna në formën e dhunë seksuale, dhunës komunitare etj.	CRAIECPAT	Pika 8 - Pranohet Pika 10 - Nuk pranohet	

	Rekomandim: Çështja e dhunës duhet të jetë një element më vete, brenda strategjisë, pra dhuna në shkollë, ose shkolla të sigurta për çdo fëmijë. 6. Në draft strategji mungon vunerabiliteti i fëmijëve të cilët nuk janë të përgatitur. Fëmijët vijnë plot vunerabilitete. Si e realizon asistencën për mbështetjen e kësaj kategorie fëmijësh dhe si realizohet lidhja brenda shkollës për menaxhimin e situatave të tilla. 7. Nxënësit nuk janë të sigurt në komunikimin online me mësuesit, nëpërmjet rrjeteve sociale si psh. ehatsApp që nuk ndodh në asnjë vend tjetër. MASR nuk ka politika ose disa standarte se kur duhet të përdoren këto rrjete sociale apo platformat e tjera dhe sa të kontrollueshme janë ato. 8. Në strategji mungon qasja mbi të drejtat e fëmijëve. Një strategji që nuk vendos në qendër të saj respektin, garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve do të thotë që nuk është e bazuar në standarte të përcaktuara në kushtetutë dhe në konventën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve ndaj e cila është një dokument bazë i detyrueshëm për çdo institucion në Shqipëri. 9. Mungon çështja e arsimit parashkollor, ose të bëhet një strategji më vetë ose të biem dakort që të jetë pjesë e strategjisë së madhe e arsimit, pra të trajtohet arsimimi i fëmijëve në fëmijërinë e hershme. Ky faktor lidhet me kriminalitetin për mbrojtjen në këtë moshë, pra të bëhet lidhja e sjelljes sociale të tyre me mosarsimin. 10. Mënyra se si është trajtuar çështja e shkollave speciale, duket sikur shkollat speciale do të hapen në çdo qytet, gjë që është përtej logjikës së arsimit gjithëpërfshirës cilësor. Pra, ka nevojë të riformulohet çështja e arsimit në shkollat speciale. 11. Sipas kërkesës që j'ua kemi bërë publike edhe herë të tjera, pyetja është se kur do të krijohet grupi lokal i arsimit?			
--	---	--	--	--

	Financimi nuk është i garantuar në këtë draft strategji. N.q.s MASR do të kishte bërë një “Leg”, sot do të kishim mundësi që të kishim një financim të huaj marrë nga një sërë programesh ose zyrsh ndërkombëtare që kanë të bëjnë me arsimin parauniversitar dhe atë universitar. Moskrijimi i legut krijon mangësi.			
84. Gjuha e shenjave	Ndryshimi i Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 837, datë 3.12.2014; Për njohjen e gjuhës së shenjave në Republikën Shqipërisë Objektivi specifik:3.4. Kuadri ligjor dhe institucional Produkti, Masat: 3.4.1. Kuadri ligjor	Shoqatat ANAD	Refuzuar	VKM-në nr. 837, datë 3.12.2014 e kemi përfshirë si akt referencë në strategji. Ajo parashikon hapjen e programit të gjuhës së shenjave në institucionet e AL.
85. Instituti I nxënësve që nuk dëgjojnë	Të plotësohet informacioni rreth situatës së edukimit të nxënësve që nuk dëgjojnë dhe mësuesve të Institutit të Nxënësve që Nuk Dëgjojnë rreth sfidave dhe cilësisë së arsimit në këtë fushë duke u referuar tek studimi”Raport Rreth Situatës Së Edukimit Të Nxënësve Që Nuk Dëgjojnë Në Shqipëri”. Studimi të vendoset si reference në dokumentin strategjik. Objektivi specifik: 4.3 Arsimi Parauniversitar Produkti, Masat: 4.3.1. Gjithëpërfshirja dhe barazia në arsim Të rritet bashkëpunimi me ASCAP në lidhje me hartimin e kurrikulave shkollore të nxënësve që nuk dëgjojnë , zhvillimin profesional dhe realizimin e vlerësimit të nevojave për zhvillim profesional të mësueseve që punojnë me fëmijë që nuk dëgjojnë. Objektivi specifik: 4.3.2 Mësuesit	Shoqatat ANAD	Pranohet	Është përfshirë si dokument reference në aneksin që do të ketë strategjia
86. Mësuesit ndihmës	Sigurimi i trajnimeve në gjuhën e shenjave shqipe për mësuesit ndihmës të cilët punojnë me femijë që nuk dëgjojnë në arsimin e zakonshëm.	Shoqatat ANAD	Refuzohet	SKA nuk është e mundur të jetë aq specifike. Kur flitet

	Objektivi specifik A1: Gjithëpërfshirja dhe barazia në arsim Produkti A1.3. Sigurimi i arsimit cilësor për fëmijët nga grupet vulnerabël Produkti,Masat: A1.3.1. Zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve, drejtuesve të shkollave, punonjësve socialë/psikologëve shkollorë, autorëve të teksteve mbi çështjet e edukimit të nxënësve që nuk dëgjojnë , gjuhën e shenjave shqipe, strategjitë e mësimdhënies për nxënësit që nuk dëgjojnë, hartimi I materialeve dygjuhësore, kultura e njerëzve që nuk dëgjojnë. Produktitit A1.3.2			për trajnimin e mësuesve ndihmës nënkupton trajnimin për të gjitha specifikat dhe çështjet që u përkasin MN.
87. Shkollat speciale	Të realizohet një udhëzim administrativ dhe strategji e shndërrimit te shkollave speciale në qendra burimore. Referimi i modelit te Kosovës. Produktitit A1.3.3	Shoqatat ANAD	Refuzohet	Nuk i takon strategjisë. Kjo është masë pas miratimit të saj
88. Shkollat special	Perfshirja ne programin e formimit fillestar te mesuese , trajnimin ne gjuhen e shenjave shqipe, edukimin dygjuhesor dhe strategjitë e mësimdhëies për nxënësit që nuk dëgjojnë dhe kulturën e njerëzve që nuk dëgjojnë. Objektivi specifik A2: Mësuesit Produkti A2.1.1.	Shoqatat ANAD	Pranohet	
89. Arsimi special	Edukimi është e mirë publike, gjithëpërfshirja buron prej këtu. Në krejt frymën e Strategjisë duhet vënë themeli se edukimi është e mirë publike. Strategjia duhet te parashikojë hapa konkret të përfshirjes së cdo aktori në fushën e edukimit, në cdo hallkë; si në atë të analizës ashtu edhe të propozimeve dhe duhet përkthyer në hapa dhe linja konkrete. Ja disa shembuj që influencohen nga kjo qasje jo gjithëpërfshirëse:	Koordinator Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar	Refuzohet	Mësues ndihmës ka për arsimin privat.

	A. Gjithë strategjia duhet të synojë përfshirjen e fëmijëve me AK dhe aksesin në arsimin jo special të tyre. Ndaj duhet t'u njihet e drejta e mbeshtetjes me mësues ndihmës jo vetëm në shkollë, por edhe në arsimin parashkollor. Kjo jo vetëm për fëmijët që zgjedhin arsimin publik, por edhe atë privat. Nëse arsimi është e mrië publike me fëmijën në qendër ky shërbim duhet të ndjekë fëmijën. Ndër treguesit e SKA, fq 76 thuhet se duhet rritur numri i mësuesve ndihmës në shkollat publike, por në logjikën e gjithëpërfshirjes duhet treguesi duhet të jetë: Rritja e numrit të mësuesve ndihmës në shkolla , pasi sikurse e thamë, shërbimi ndjek/duhet te ndjeke femijën dhe jo shkollën të cilën prindi për shumë arsye ka zgjedhur për fëmijën e ve. B. I njëjti arsyetim pasqyrohet edhe në rastin e librave falas për filloren apo të kategorive që e përfitojnë. Në fakt duhet që librat t'i përfitojnë fëmijët, ku familjet duke qenë taksapagues të rregullt nuk mund të privohen nga kjo e drejtë. C. Sistemi i menaxhimit të informacionit SMIP, është për t'u lavdëruar, por kërkohet një informim më i plotë për marrëveshjen që MASR ka lidhur me AKSHI -n. Kjo pasi përgjegjësitë juridike të drejtuesve të shkollave private i detyrojnë ata të kenë dijeni direkte për këtë marrëveshje të cilën duhet ta njohin dhe ta aprovojnë, pasi meqë bëhet fjalë për të dhëna të ndjeshme ata janë përgjegjës ndaj familjeve për garantimin e privatësisë. D. është e nevojshme të shprehet në Strategji një autonomi në eksperimentim për sa i përket shkollave private, por edhe në përgjithësi, që është edhe në favor të përmirësimit të sistemit arsimor shqiptar, kuptohet përherë e monitoruar. Kjo mundësi do të conte më përpara shkollën shqiptare dhe do të përshpejtonte procesin e përvetësimit të risive në arsim si për shembull: Gjuhët e huaja, Etika, TIK-u, Metodogjia STEAM, Flipped Classrom. etj.			
--	---	--	--	--

	E. Bashkëpunimi me sektorin privat edhe në procesin e rajonalizimit do të bënte të mundur eliminimin e klasave kolektive, investimin e racionalizuar të shkollave të reja, duke gjetur marrëveshje me sektorin privat -jofitimprurës në favor të fëmijëve.			
90. Formimi professional I mësuesve	3. Formimi i mësuesve dhe bashkërendimi i punës mes arsimit parauniversitar dhe Universitar A. Një shkollë e së ardhmes domosdoshmërisht kërkon një ripërtëritje të programeve formuese fillestare të mësuesve, pra të kurrikulës universitare, po ashtu edhe të Agjencive trajnuese që kontrbuojnë në zhvillimin profesional. Në këndvështrimin tonë Formimin e vazhdueshëm duhet ta ofrojnë agjenci të tjera ndërsa Universitetit kryesisht të fokusohet në formimin bazë fillestar të mësueve të ardhshëm duke fuqizuar kërkimin shkencor, zhvillimi serioz i tij është kontributi më i vyer drejt një përmirësimi të qëndrueshëm të arsimit në vijim. B. Në fq 78 pika A2.3.2. Ku flitet për performancën e mësuesit në shkollë, mund të mendohet gjatë këtyre viteve edhe aspekti formativ in loco, sikurse edhe ai i rrjeteve profesionale, që të mund të monitorohen dhe akreditohen. Kjo do të kontribuonte për planifikimin e zhvillimit profesional të cdo shkolle, që do përkthehej në rezultate konkrete të përmirësuar të nxënësve. Ftojme Ministrinë të gjejë mënyrën për të fuqizuar dhe monitoruar zhvillimin profesional brenda shkollave që ato të abilitohen dhe prodhojnë module formavite (ndoshta edhe të akredituara ose të paktën të njohura si formim për vetë shkollën si alternativë ad hoc për mësuesit e cila ndër të tjera ëshët edhe më pak e kushtueshme për ta. C. STEM qasja globale e formimit të studentëve për të cilën fliete tek pika C3.3.1; Promovimi i ndërdisiplinaritetit dhe programve STEM. Kjo është një qasje në nxit drejtpërdrejt zhvillimin ekonomik dhe punësimin e të rinjve në të ardhmen.	Koordinator Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar	Pjesërisht dakord	Lidhur me performancën e mësuesit në shkollë jemi dakord me fuqizimin e zhvillimit të vazhduar profesional në nivel shkolle, por akreditimi i moduleve të trajnimit organizohet në nivel kombëtar. Monitorimi i zhvillimit të brendshëm profesional brenda shkollës aktualisht është përgjegjësi e drejtorit të shkollës dhe njësive arsimore vendore.

	Mendojmë që duhet të gjejë pasqyrim tek formimin fillestar dhe i vazhdueshëm të mësuesve sikurse kjo duhet të jetë një qasje më serioze për përgatitjen e fëmijëve tanë që të paraqiten denjësisht në provimet ndërkohmëtare PISA etj. Mbetemi në kontakt dhe në dispozicionin tuaj për bashkëpunime si në bashkëndarjen e praktikave të mira, si në bashkëndarjen e ekspertizave kombëtare dhe ndërkombëtare që ne kemi, por dhe në mbështetje të iniciativave të përbashkëta për zhvillime pozitive për nevoja që ju mendoni që mund të jemi ndihmues.			
91. Në lidhje me raportet dhe analizat e ndryshme	A. Në Strategji nuk reflektohet sa duhet gjendja aktuale e shkollës. Analiza kryesisht I referohet e së shkuarës, sikurse kllapa e Pandemise të mos ketë lënë gjurmë dhe të mos ketë pasoja në mësimdhënien e mëtejshme. Gjej me vend që duhet reflekuar mbi raportin Progresiv të Unescos3 dhe në përgjithësi për frymën që sjell, në të cilin përvijohet urgjenca për të menduar një shkollë ndryshe, për të planifikuar një ndryshim rrënjësor. Duhet të jemi të vetëdijshëm se do të kthehet më ai model që në rrang botëror ishte në krizë edhe para Pandemisë, e cila vuri më në hap plasaritjet dhe incongruencat në të. Reflektimi mbi krizën në arsim duhet shoqëruar me hapa konkrete në Strategji e cila ndonëse 5 vjecare duhet të ketë një frymëmarrje më të gjërë të paktën deri në 2050. B. Është me vend të rishikohet përvoja e ndarjes së sistemit tonë shkollor të detyrueshëm dhe të mesëm të lartë në formulën 5+4+3. Sipas nesh duhet një analizë dhe eventualisht një ndryshim. Në përvojën tonë na rezulton në mënyrë konstante, që kjo ndraje është e papërshtatshme për vetë zhvillimin dhe nevojat fiziologjike dhe psikologjike të 14-15 vjecarë. Për më tepër do të sugjeronim variantin 5+3+5 (Pra edhe shtimin e një viti të shollës së mesme të lartë ose të pakten 5+3+4). Argumentet për ta rritur kohëzgjatjen e gjimnazit janë të shumta	Koordinator Kombëtar i Edukimit Katolik Shqiptar	Pranohet pjesërisht	Është marrë parasysh sugjerimi që të hartohen raporte kombëtare për maturën shtetërore.

	në përvojën tonë dhe sigurisht nëse bëhet një analizë e plotë, profesionale dhe gjithëpërfshirëse do të jenë shumë bindëse. C. Analiza e maturës shtetërore dhe provimet e tjera shtetërore. Në fq 81 pika A3.4 Flitet për besueshmërinë e vlerësimeve të testeve kombëtare. Nuk e dimë nëse është bërë një analizë paraprake dhe e thellë mbi këtë pikë. Gjykuar nga evidentimi i mungesës e besueshmërisë duket se analiza është bërë tashmë, ndaj duhet reflekutar mbi shkaqet e këtij fenomeni të cilat do të ishin baza për të planifikuar një ndërhyrje sistemike në lidhje me besueshmërinë. Sipas nesh kjo ndërhyrje do të shkonte në dy drejtime: 1. Formim personal etik i mësuesve dhe drejtuesve (rrjedhimisht i nxënësve) e cila është themra e akilit por mund të jetë edhe gur themeli për luftën kundra korrupsionit 2. Gjetjen e mënyrave më të gjëra të vlerësimit duke e personalizuar më shumë formimin e nxënësve pra edhe maturën shtetërore si institucion. Si maten aftësitë shprehëse të nxënësve tanë? si maten gjatë provimit aftësitë argumentuese? si matet realisht puna e bërë në 3 vitet të gjimnazit? Po të pyeten mësuesit mësuesit në një analizë të sinqertë dhe profesionale, nëse rezultatet e maturës matin vërtet nxënësit që ata i njohin mirë? besoj do ta kemi të qartë tablonë e mangësive që sjell matura shtetërore bazuar vetëm mbi testet me shkrim, sikurse ndodh tashmë prej shumë vitesh. Rezultatet e pakënaqshme në testime ndërkombëtare si PIZA etj., pasqyrojnë patjetër qasje të kahershme të bëra në sistem me në fokus maturën shtetërore sikurse e njohim.			
92. Disa sugjerime dhe rekomandime	1. Në qendër të strategjisë të vendoset dhe edukimi në fëmijëri të hershme. 2. Mësuesit ndihmës për fëmijët me AK, duhet të kenë edhe në shkollat private,	Koordinator Kombëtar i Edukimit	Pranohet	

	3. Për këtë kategori nxënësish të ketë tekste të posaçme. 4. Me eksperimentimin e kurrikulës së re duhet të bëjmë “actor” edhe arsimin privat, pasi kjo mund të sjellë risi për implementim e saj, pasi aktorët që mbështesin edukimin janë sektori shtetëror dhe ai privat 5. Për sigurinë e nxënësve në shkollë (shkolla e sigurt për fëmijët) nuk është vetëm detyrë e oficerit të sigurisë, por duhet të fuqizohet prsoneli i shkollës në bashkëpunim me prindërit. 6. Në draft strategji ka disa analiza të munguara si vlerësimi i maturës shtetërore në vite, sistemi i shkollës (5+4+3), edhe pandemia “Covid-19”, pra të bëhet një analizë më e thellë në këto çështje. 7. Vlerësimi i mësuesve të përqëndrohet jo vetëm te etika profesionale por dhe te etika personale	Katolik Shqiptar		
93.Arsimi special	1. Lidhur me aftësinë e kufizuar, shkollat speciale të kthehen në qendra burimore për të siguruar gjithëpërfshirje në arsim. 2. Komisionet e vlerësimit nuk funksionojnë ashtu si duhet, lidhur me vlerësimin mjekësor të fëmijëve me AK. 3. Të parashikohet sasia e kohës që duhet ti kushtojë mësuesi ndihmës fëmijës me AK, gjithashtu mësuesit ndihmës qëndrojnë shumë pak, të cilët pasi trajnohen nuk qëndrojnë në këtë profil, por shkojnë mësues, pra të parashikohet që të ketë një kohëzgjatje në profesionin e tyre. 4. Standartizimi i planeve planeve edukative individuale (PEI). 5. Transporti i nxënësve të zonave rurale në shkollë, pasi prindërit e kanë të pamundur të çojnë fëmijët në shkollë si dhe aksesit pasi ka shkolla të paaksesueshme për fëmijët me AK. 6. Ka shumë mosrakordime mbi numrin e fëmijëve që ndjekin shkollën, pra 12-13% e fëmijëve me AK ndjekin shkollën e cila është një shifër tepër e ulët. Nëse fëmija me AK nuk mund të ndjek shkollën ti ofrohet shërbimi në shtëpi.	Agjencia trajnuese e mësuesve MEDPAK	Refuzohet	Janë më së shumti konstatime dhe shumë specifike për të qenë pjesë e strategjise

94.Arsimi i pakicave kombëtare	Në vijim të angazhimeve të qeverisë shqiptare në kuadër të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Konventës Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe Kartës Sociale Evropiane, si edhe Deklaratës së Partnerëve të Ballkanit Perëndimor mbi Integrimin e Romëve në Procesin e Zgjerimit të BE-së dhe Kornizës Strategjike Rome të BE-së për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrje 2020-2030, Shqipëria është e angazhuar për të vijuar përpjekjet për barazi të plotë dhe integrimin e romëve në shoqërinë shqiptare. Duke marrë parasysh procesin e hartimit të dokumentit të Strategjisë së Arsimit Parauniversitar 2021-2026 të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve. KPK Komitetit për Pakicat Kombëtare Rekomandon konsiderimin e Rekomandimit të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për 47 shtetet anëtare “Për përfshirjen e historisë dhe kultures së romëve në kurrikulat shkollore dhe materialet mësimore”, miratuar më 01 korrik 2020. Komiteti për Pakicat Kombëtare Rekomandon si më poshtë : Përfshirjen e historisë, kultures, artin rom dhe Samudaripen (Holokausti Rom), në kurrikulat shkollore dhe materialet mësimore, me qëllim ndërtimin e një kulture të tolerancës dhe respektit në shkollë; zhvillimin e vetëdijes historike dhe vetëdijes së të gjithë nxënësve; kontribuimin në pohimin e identitetit të romëve; dhe përmirësimin e të kuptuarit se romët janë pjesë përbërëse dhe një vlerë e shtuar e shoqërisë shqiptare. Masa të sugjeruara në realizimin e këtij objekti: • Hartimi i një moduli të veçantë mbi historinë, kulturën dhe artin e romëve përfshirë hulumtimin mbi Samudaripen (Holokaustin Rom) dhe persekutimet e tjera historike si pjesë e kurrikulës shkollore dhe materialeve mësimore për klasat e arsimit të detyrueshëm në Shqipëri	Komiteti për Pakicat Kombëtare		Janë përfshirë në strategji. Është përfshirë historia rom dhe egjiptiane. Janë bërë dhe programet për gjuhën rom që janë miratuar dhe vendosur. Nuk duhet të përfshihet në strategji se është e përfshirë te modulet që ne nxjerrim.
---------------------------------------	--	---------------------------------------	--	--

	• Hartimi i një Udhëzuesi dhe trajnime për Mësuesit për mësimdhënien e historisë dhe kultures së re në shkollë • Buxhetimi i këtyre nismave dhe indikatorët tregues për arritjen e objektivave që do të parashikohen është gjithashtu shumë i rëndësishëm			
95. Digjitalizimi	E vlerësojmë draft strategjinë e re për sa më poshtë vijon: 1. Implementimi i projektit bashkëpunues midis MASR dhe British Council që ka për qëllim digjitalizimin, gjithëpërfshirjen dhe aftësimin e mësuesve. 2. Në kuadrin e gjuhës angleze, British Council po planifikon projektin “Future English” për Ballkanin Perëndimor i cili ka të bëjë me zhvillimin e kapaciteteve të mësuesve të gjuhës angleze dhe trajnimin e tyre me platforma online, zhvillimin e aftësive digjitale të nxënësve dhe zhvillimin e kapaciteteve të mësuesve.	British Council		
96. Politika A, e strategjisë.	Duke u bazuar tek vizioni i strategjisë, i cili ndër të tjera vendos theksin tek parimi i barazisë sugjerojmë që Qëllimit të Politikës A t’i shtohet komponenti i Barazisë në arsim duke e riformuluar: Qëllimi i politikës A: Arsim parauniversitar cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë që krijon kushte që të gjithë nxënësit, pa asnjë dallim, të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike; të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë	Koalicioni për Arsimin në Shqipëri	Pranohet	
97. Riformulim produkti	Produkti 1.3.3 sygjerohet që të riformulohet “Kthimi I Shkollave speciale në qendra burimore për aftësinë e kufizuar”	Koalicioni për Arsimin në Shqipëri	Pranohet	
98. Riformulim produkti	Produkti A1.4. Rritja e cilësisë së (të shtohet ofrimit të) shërbimit psiko-social për të gjithë nxënësit A1.4.3. Hartimi i protokolleve të punës për shërbimin psiko-social- Ju bëjmë me dije se Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijët ALO 116 11 11 ka hartuar këto protokolle, dhe mund t’ua	Koalicioni për Arsimin në Shqipëri	Pranohet	

	vendosim në dispozicion në çdo moment, dhe i vjen në ndihmë MASR për uljen e kostove për këtë nënprodukt.			
99. Mjediset e sigurta në shkolla	Përsa i përket Produktit A1.7. Konsolidimi i mjediseve të sigurta dhe miqësore për fëmijët në shkollë sugjerojmë që të jetë më i detajuar si produkt se çfarë synon që të arrijë, kjo për të pasur një orientim më të qartë. Për këtë ne sugjerojmë që të përfshihet në këtë produkt: A1.7. Konsolidimi i mjediseve të sigurta dhe miqësore për fëmijët në shkollë nëpërmjet hartimit dhe miratimit të planit të veprimit për shkolla të sigurta.	Koalicioni për Arsimin në Shqipëri	Pranohet	
100. Disa sugjerime dhe rekomandime	1. Në strategji nuk përmendet si do ti bëjmë fëmijët aktiv përsa i përket jetës në shkollë, çfarë masash konkrete do të ketë kjo strategji lidhur me këtë çështje. 2. Nuk është planifikuar se sesi kjo strategji adreson analfabetizimin funksional, pasi sipas statistikave 52% e fëmijëve në Shqipëri nuk arrijnë të kuptojnë dhe të riprodhojnë atë çka kanë lexuar. 3. A është planifikuar se sa do jetë efektive kjo strategji në rast të një fatkeqësie si tërmet apo pandemi tjetër.	Koalicioni për Arsimin në Shqipëri	Pranohet	Pika 3. Do shtohet te pjesa e analizës nje informacion. Te futet te fusha tematike “Mesuesit te trajnimet e mësuesve ose te konsolidimi i mjediseve të sigurta” A1.7 të shtohet A1.7.5 Të shtohet një produkt që vlerëson angazhimin në kuadër të emergjencave civile. Janë disa nga masat që duhet të përfshihen: 1. Konsolidimi i paketës të të gjithë akteve që na

				orientojnë për emergjencat civile (termet, pandemi,permbytje) 2.Module trajnimi për mësuesit,nxënësit për emergjencat civile 3.Trajnimi i mësuesve për agjencite trajnuese kur shpallet thirrja, të vendoset një modul dhe tematikat. 4.Planet e shkollave të jenë praktike për mënyrën si të reagojnë në situata emergjente
101. Disa sugjerime dhe rekomandime	1. Meqënëse në parim strategjia mbështetet në politikën e menaxhimit dhe sigurimit të cilësisë, sugjerojmë që të përfshihet dhe institucioni ynë për inspektimin dhe monitorimin e trajnimeve të stafeve pedagogjike, pasi kemi në bashkëpunim me ASCAP kemi marrë pjesë në hartimin e standarteve. 2. Të parashikohet studimi i nevojave të drejtuesve të arsimit parauniversitar, pasi ne ofrojmë mbështetje për trajnimin dhe certifikimin e tyre. 3. Te masat e drejtimit dhe menaxhimit të arsimit parauniversitar, propozoj të krijohet shoqata e drejtuesve të	Qendra e Shkollës së Drejtuesve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar.	Refuzohet	Ky rekomandim refuzohet, pasi, bazuar në nenin 25/3 të ligjit 69/2012, i ndryshuar, janë krijuar ASCAP-i dhe DPAP-ja, të cilët kanë për detyrë monitorimin e agjencive

	institucioneve të arsimit paruniversitar me individë të certifikuar nga institucioni ynë për të qenë dhe anëtarë të Shoqatës Evropiane të Drejtuesve të APU.		trajnuese. Gjithashtu, në nenin 27/1 të ligjit 69/2012 , citohet qe: "Shkolla e Drejtorëve" është person juridik, që ka për qëllim zhvillimin profesional të drejtuesve dhe kandidatit për drejtues të institucionit arsimor parauniversitar, publik ose privat, administrimin e procesit të trajnimit të detyrueshëm përgatitor për pajisjen me certifikatë për drejtimin e institucioneve arsimore parauniversitare dhe të trajnimit të vazhdueshëm të drejtuesve". Ky sugjerim tejkalon kompetencat e funksioneve të
--	---	--	--

				Shkolles së Drejtoreve.
102. Kodifikimi i programeve/programeve profesionalr	1. Në strategji është e rëndësishme të pasqyrohet sigurimi i standarteve dhe cilësinë, për të pasur kodifikim të programeve dhe lëndëve përkatëse dhe standardizim të programeve tona të IAL-ve me programet e Bashkimit Europian. Pra programeve midis universiteteve të vendit në masën 70%. 2. Arsimi i lartë profesional 2-vjeçar duhet të ndjekjek tregun e punës dhe profesionet e kërkuara të cilat janë me mungesa edhe në tregun ndërkombëtar të punës. Pra disa profesione të specifike të mbulohen nga persona që kanë përfunduar arsimin professional 2-vjeçar	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës	Refuzohet	Është adresuar kjo çështje në strategji
103. Disa sugjerime dhe rekomandime	1. Rekomandojmë që në SKA, arsimi parashkollor të trajtohet si një rubrikë të vecantë, pasi i përfshirë në arsimin para-universitar, nuk gjendet qartësia dhe rëndësia e trajtimit të këtij funksion. 2. Të percaktohet saktë kompetencat e institucionit i cili do të ofrojë shërbimin për grup moshat 5-6 vjec, Rekomandojmë që këto grupmosha të atashohen pranë kopshteve. 3.Rekomandojmë përfshirjen e qeverisjes lokale në planin kombëtar për integrimin dhe standartizimin e kurrikulës së arsimit parashkollor 4. Rekomandojmë që kurrikula të jetë e unifikuar për të gjithë, ku 30% e saj mund t’i lihet e lirë mësuesesve dhe komunitetit që të përshtasë me nevojat dhe dëshirat e tij duke e bërë edhe kopshtin Qëndër Komunitare . Kjo kurrikulë duhet të jetë e shoqëruar edhe me materialet ndihmëse për realizimin e saj bashkë me katalogun e literaturës të miratuar nga MAS. 5. Rekomandojmë një rritje të financimit të arsimit parashkollor, në infrastrukturë, për përmirësimin e kushteve në kopshte dhe	Shoqata për Autonomi Vendore	Pranuar pjesërisht	Të gjitha sugjerimet janë adresuar në një formë ose në një tjetër në strategji. Rishikimi i gjithë proceseve që ndodhin në arsimin parashkollor dhe kordinimi i veprimtarive. Rishikimi i gjithë paketës së arsimit parashkollor, të gjithë anës ligjore, përgjegjësi për çdo institucion që mbulon arsimin parashkollor etj. Është vendosur si

	ofrimin e shërbimit për cdo fëmijë (mësuesit ndihmës dhe psikologun). 6. Rekomandojmë identifikimin që në moshë të hershme për fëmijët me aftësi ndryshe, dhe mbështetja financiare për shtimin e numrit të mësuesve ndihmës dhe psikolog për arsimin parashkollor. 7.Rekomandojmë ndryshimin e kuadrit ligjor për administrimin e portalit mësues për Shqipërinë duke përfshirë pushtetin lokal për procesin e rekrutimit lidhur me arsimin parashkollor. 8. Ne funksion të gjithëpërfshirjes, rekomandojmë: Mësuesi ndihmës duhet të ketë formimin e nevojshëm akademik specifik, të jenë të specializuar për fëmijët me aftësi ndryshe Psikologu të jetë me prezent dhe të mbështesë realisht punën në kopësht, gjë që realizohet duke ulur numrin e kopshteve që ai mbulon Komisionet multidisiplinare që përcaktojnë nevojën e këtyre fëmijëve, duhet të kenë edhe përfaqësues nga pushteti lokal (të arsimit parashkollor) si personat përgjegjës që do ndjekin procesin e integritetit të tyre me fëmijët e tjerë. Sa më e hershme dhe cilësore të jetë kjo gjithëpërfshirje dhe ndërhyrje aq më të mëdha do të jenë përmirësimet dhe arritjet e fëmijës. 9. Rekomandojmë që klasa përgatitore për grup moshat 5-6 vjec të bëhet e detyrueshme e pilotuar ne disa bashki pasi rrit cilësinë e arsimit. 10. Rekomandojmë trajnim të stafit mësimor për arsimin parashkollor. 11.Rekomandojmë qe strategjia duhet të përcaktojë limitimin të grupeve të përziera, por t'i japi më shumë rëndësi duke ofruar si alternativë grumbullimin e tyre në qendra administrative në zonat rurale. 12. Rekomandojmë një rritje të bashkëveprimit mes shkallëve të edukimit, nga çerdhja tek kopshti tek shkolla fillore, për këtë			produkt të gjithëpërfshirja. A1.1.2 është e përfshire. Do të parashikohet diçka për aktet ligjore në fuqi. Për avancimin dhe menaxhimin e këtij sektori duke rivlerësuar dhe njëherë të gjithë sistemin e akteve ligjore në fuqi.
--	--	--	--	--

	bëhet i nevojshëm shkëmbimi i informacionit mes institucioneve të arsimit. Që nga çerdhja çdo fëmijë duhet të ketë një dosje të tij personale që përcillet nga njëri institucion në tjetrin. Dokumentimi i këtij procesi në të gjitha drejtimet si nga ana zhvillimore, ashtu edhe në ecurinë e nivelit të njohurive që ai ka marrë dhe përcjellja e saj bashkë me fëmijën në momentin që ai bëhet pjesë e arsimit bazë, do të jetë një piketë shumë e rëndësishme për të mbështetur mesuesja punën e saj 13. Rekomandojme konsolidimin e një pakete për vlerësimin e cilësisë së kopshteve, si dhe ngritjen e kapaciteteve të kopshteve duke përfshirë drejtues dhe mësues. 14. Rekomandojmë të citohet arsimi parashkollor mbi përfshirjen e femijeve nga grupet vulnerabel. Të parashikohet pilotim i qendrave të tilla dhe për arsimin parashkollor. 15. Rekomandojmë që të rivlerësohet numri raportit psikolog / fëmijë, pasi ky raport është i pamundur. Rekomandojmë rritjen e financimit për punonjësin social dhe psikologun. 16. Rekomandojme qe Partnerët zhvillimorë duhet të asistojnë me programe dhe trajnime arsimin parashkollor për përmirësimin e klimës në kopshte, në edukimin dhe sensibilizimin për parandalimin e hershëm bullizmit,... Proçesi i trajnimit duhet të ndiqet nga rrjetet profesionale dhe të jetë në një shpërndarje sa më kapilare për të bërë pjesë sa më shumë personel arsimor në këto trajnime . 17. Rekomandojmë Hartimin dhe standartizimin e kurrikulave dhe mjeteve arsimore për arsimin parashkollor. 18. Rekomandojme qe Shkolla e drejtorëve të trajnojnë edhe drejtuesit e kopshteve. 19. Rekomandojmë se përcaktimi i standarteve të drejtorit është i rëndësishëm, sepse percakton në një kornizë konkrete se si duhet të jetë ky drejtues, një menaxher dhe profesionist i mirë në të gjithë komponentet e tij .			
--	---	--	--	--

	20. Rekomandojmë përmirësimin e funksionimit të portailit duke krijuar hapsirë për kritere nga qeverisja vendore “Mësues për Shqipërinë” të shikohet mundësia më e mirë e përzgjedhjes së lokalizimit kur bëhet fjalë për mësuesit e kopshteve. Shpeshherë kopshtet që ndodhen në zona rurale ngelen pa mësues pasi mësuesit zhvendosen në kopshtet në qytet. 21. Vlerësojmë zgjedhjen e mësuesit nga portali, por ky mekanizëm ka nevojë të modifikohet me mekanizma monitorimi dhe vëzhgimi në një periudhë të caktuar për të rritur cilësinë e mësuesve që bëhen pjesë e këtij niveli të arsimit, mekanizma që duhet të jenë në dorë të organeve vendore dhe specialistëve të fushës, duke rritur kohëzgjatje e periudhës së provës së mësueseve që emërohen nga portali. Rekomandojmë që mësuesit ndihmës duhet të zgjidhen nga një komision multidisiplinor me përfaqësim të qeverisjes vendore dhe qendrore, ku nuk shihet e nevojshme përzgjedhja e tyre nëpërmjet portalit.			
104. Cilësia në arsimin e lartë	Në strategji përmendet gjithpërfshirje dhe rritja e cilësisë në Arsimin e Lartë Universitar. Gjithpërf shirja është tejkaluar pasi në bashkonë Tiranë janë 40 institucione ië IAL-ve pra 14 institucione/1000 banorë, krahasuar me normën e BE-së që është 7 institucione/1000 banorë. Rekomandoj që: 1. Strategjia të përafrojë misionin e IAL ve me politikat e zhvillimit social të vendit Të profilizohen IAL-të sipas rajoneve, pasi strategjia e thellon pabarazinë midis rajoneve pasi në rajonin Tiranë- Durrës jetojnë 80% e banorëve. 2. Të gjitha IAL prodhojnë vetëm mësues, pra ato të profilizohen sipas tregut të punës që ka rajoni. 3. Lidhur me kërkimi shkencor dhe stafet akademike, në strategji nuk jepet qartë si do orientohet kërkimi shkencor pasi për të duhet treg dhe si e keni evidentuar që ka treg për kërkimin	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës		

	shkencor, ose të ketë koherencë midis kësaj strategjie dhe strategjisë së kërkimit shkencor.			
105. Disa sugjerime dhe rekomandime	E vlerësojmë draft strategjinë e re për sa më poshtë vijon: 1. Grupeve vunerabël, janë fëmijët që kanë vështirësi ekonomike, që braktisin shkollën apo në prag të braktisjes të nxitim arsimimin e tyre përmes ofrimit të bursave. 2. Regjistrimi online i nxënësve në në klasën e parë dhe klasën e 10-të është një hap i rëndësishëm për përfshirjen e grupeve vunerabël në arsimin parashkollor. 3. Kordinimi i sistemit të menaxhimit të informacionit në sistemin e arsimit të lartë dhe arsimin privat.	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve	Pranuar	
106. Strukturat e brendshme në shkolla	Eshtë e rëndësishme që, në kuadër të procesit të decentralizimit dhe përpjekjeve për forcimin e qeverisjes demokratike të shkollave e krijimit të shkollave sa më gjithëpërfshirëse e demokratike, t'i kushtohet vëmendje e veçantë zgjedhjeve demokratike e fuqizimit të Strukturave të brendshme, veçanërisht Këshillave të Prindërve, Bordit të Shkollës dhe Qeverisë së Nxënësve. Eshtë e nevojshme që përfshirja dhe roli i prindërve si edhe i nxënësve në procesin e vendimmarrjes dhe në gjithë procesin e zhvillimit e përmirësimit të shkollës të theksohet në mënyrë të qartë e t'u kushtohet vëmendje e veçantë. Mbështetja për hartimin dhe zbatimin e Planeve të mirëfilltë të bashkëpunimit e Partnerit Shkollë-Familje-Komunitet si pjesë integrale e Planeve gjithëpërfshirës të Zhvillimit të Shkollave, do të kontribuonte në rritjen e përfshirjes dhe bashkëpunimit të prindërve, si partnerët kryesorë të shkollave dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm në procesin e ndryshimeve pozitive e të qëndrueshme në përmirësimin dhe demokratizimin e gjithë jetës së shkollës.	Shoqata Fëmijët Janë e Ardhmja.	Pranohet	
107. Autonomia e shkollave	Gjithashtu, në kuadër të rritjes së nivelit të autnomisë së shkollave, duke vlerësuar përpjekjet dhe hapat pozitivë për	Shoqata Fëmijët Janë e Ardhmja.	Pranohet	

	lehtësimin e procedurave lidhur me menaxhimin e buxheteve të krijuara nga kontributet e prindërve apo të përfituara nga donatorë të ndryshëm, do të theksonim rëndësinë e madhe të rritjes së investimit nëpërmjet akordimit të fondeve për secilën shkollë me të drejtën e menaxhimit nga vetë shkollat në varësi të nevojave dhe interesave të nxënësve të tyre dhe komunitetit të shkollës, në funksion të krijimit të kushteve sa më të favorshme për mirëqenien dhe zhvillimin e gjithanshëm të secilit nxënës dhe mbështeten e veçantë të fëmijëve nga grupet më në nevojë.			
108. Nxënësit që i përkasin komunitetit Rom	Referuar qëllimit të politikës A: Arsim parauniversitar cilësor dhe gjithëpërfshirës që krijon kushte që nxënësit të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike; të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë, Konkretisht Objektivi specifik A1 që synon gjithëpërfshirje dhe barazi në arsim, Rekomandimi ynë si Organizate që punon me komunitetet e marginalizuara, konkretisht ai Rom, lidhet pikërisht me fokusin që duhet të ketë kjo strategji në gjithëpërfshirjen e fëmijëve nga komunitetet e kësaj etnie. Sipas të dhënave të marra nga strategjia për vitin 2018/2019 ku në shkollat Shqiptare figurojnë të regjistruar 5000 Rom dhe 11,100 Egjiptjanë shihet si nga institucionet arsimore shterore ashtu edhe nga organizatat që punojnë në terren vështirësi nga fëmijet, kryesisht ata Rom për të marrë piket e nevojshme për kalimin e klases së V-të. Numrat e fëmijëve Rom që regjistrohen në klasat me lartësi sa vjen edhe rrallohet për arsye të ndryshme për këtë arsye rekomandimi ynë është që kjo strategji të fokusohet më tepër në bashkërendimin e forcave së bashku me gjithë aktoret e tjera (shkollat, OJF, Sherbimi Social etj) për të mundësuar rritjen e numrit të fëmijëve nga minoritetet që regjistrohen dhe frekuentojnë klasat e arsimit të mesëm të ulët, dhe me konkretisht puna me e madhe	ADRA Albania		

	t'i dedikohet rregjistrimit ne klasen e V-te si edhe kalimin ne klasen e VI-te aty ku shihet se shkolla braktiset me teper nga femijet e ketij komuniteti. Nisur nga eksperienca jone, integrimi i femijeve Rom ne te gjitha sistemin parauniversitare eshte i veshtire dhe kerkon kohe ndaj realizimi i tij duhet te jete sa me strategjik dhe konkret duke e trajtuar aty ku fillon problemi (pra klasa e 5-te). Sigurisht kjo kerkon pjesemarrjen e te gjitha aktoreve te cilet duhet ti dedikohen ketij qellimi me plane, metoda dhe programe konkrete per te lehtesuar edhe punen e shkollave. Gjithashtu, duhet te shqyrtohet mundesia per organizimin e mesimit alternativ (p.sh. te mesuarit ne distance) per femijet rom qe, per arsye te ndryshme specifike, nuk mund te vijoje mesimin e rregullt ne shkolla.			
109.Braktisja e shkollës	Te permiresohet grumbullimi i te dhenave i femijeve braktises te shkolles te ndara sipas gjinise ,duke perdorur procedura standarde operative per te siguruar grumbullimin e te dhenave te besueshme. (Nga puna ne terren kemi evidentuar se te dhenat kane nevojë per perditesim) Si te rendesishem shikojme edhe ndergjesimin e popullates per arsimimin e kategorive te rrezikuara (vecanerisht femijet rom/egjyptian), nepermjet fushatave advokuese, sesioneve informuese, klipeve ne Tv . Ne vijueshmeri te ketij objektivi specifik, rekomandimi yne i dyte lidhet me permiresimin dhe pershtatjen e infrastruktures se shkollave. Ne fokusin duam ta sjellim tek shkollat publike te zonave te prekuara nga termeti te rrethit Kruje te cilat jane ende ne proces rindertimi duke kaluar cdo afat te vendosur dhe duke rrezikuar qe edhe nje semester tjeter shkollor te ndiqet ne shkolla larg vendodhjes se femijeve duke krijuar keshtu turne te dyta dhe shpesh here edhe veshtiresi kordinimi te nxenesver per shkak te hapësirave te limituara neper shkolla. Pavaresisht se infrastruktura e shkollave eshte pergjegjesi e Bashkise dhe e donatoreve vendas si Fondi Shqipetar i Zhvillimit dhe donator te	ADRA Albania Kristi Qendro		

	Huaj si Bashkimi European etj, ne mendojme qe kjo pike duhet pare me prioritet dhe Ministria e Arsimit duke ushtruar me teper presion per mbarimin e ndertimeve brenda afateve te vendosura ne menyre qe viti i ri shkollor 2021-2022 t'i gjej te gjithë femijet ne shkollat e tyre tashme me standarte Europiane			
110. Rishikim i produkteve dhe treguesve	Rekomandimet tona si EVA, jane kryesisht ne pjesen e produkteve dhe treguesve qe duket qe kane nevojë ne disa momente te theksojne disa tregues te tjere qe te arrihen rezultatet e shtyllave strategjike. Produkti A1.2. Rritja e pjesëmarrjes në arsimin parauniversitar: A.1.2.3 Koordinimi efektiv në nivel lokal mes institucioneve shkollore dhe shërbimeve të specializuara, qendrave në bashkive për përfshirjen dhe pjesmarrjen e vazhdueshme të fëmijëve në arsimin parauniversitar. Produkti A1.3. Sigurimi i arsimit cilësor për fëmijët nga grupet vulnerabël: 1.3.6. Zhvillimi i kapaciteteve të mësuesve lëndorë, drejtuesve të shkollave, punonjësve socialë/psikologëve shkollorë, autorëve të teksteve mbi çështjet e gjithëpërfshirjes, empatisë në ambientet shkollore. Produkti A1.4. Rritja e cilësisë së shërbimit psiko-social për të gjithë nxënësit: A1.4.5. Hartimi i planeve të përbashkëta dhe ndjekja e tyre mes shërbimit psiko-social shkollor, mësuesve lëndorë, mësuesve ndihmës për mbështetjen psiko-sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara, vështirësi në të nxënë, fëmijë të ri-kthyer nga emigracioni, komuniteti Rom dhe Egjyptian, vështirësi të ndryshme socio-ekonomike.	EVA ËORLD VISION ALBANIA	Pranohet pjesërisht	Një pjesë e rekomandimeve që janë bërë janë adresuar në strategji . Janë marrë parasysh A1.4., A1.6.2 , A1.6) A1.7 dhe A1.7.6 dhe A1.7.7 nuk konsiderohen

	A.1.4.6 Hartimi i planeve mbi seanca ndërgjegjësuese për shëndetin mendor dhe mirëqënien socio-emocionale të fëmijëve dhe adoleshentëve, sidomos në raste pas emergjencave. Produkti A1.6. Përmirësimi dhe përshtatja e infrastrukturës shkollore: A1.6.2. Investime për përshtatjen e infrastrukturës shkollore bazuar mbi parimet e dizenjimit universal, të targetuar dhe të specializuar duke konsideruar nevojat individuale të çdo nxënësi bazuar në parimet e modelit të Hapësirave Zhvillimore (për shkollat e reja ose për shkollat me mundësi rindërtimi/ përshtatje). Produkti A1.7. Konsolidimi i mjediseve të sigurta dhe miqësore për fëmijët në shkollë: A1.7.5. Forcimi i rolit të Qeverive të Nxënësve, klubeve të fëmijëve/ rinore në shkolla që përfshijnë aktivitete të qytetarisë aktive në planin vjetor të shkollës;			
111.Disa rekomandime dhe sugjerime në përgjithsi	Në kuader të propozimeve për strategjitë e reja të arsimit parauniversitar, Shoqata e mesuesve të gjuhës frënge ka organizuar një takim në distancë të delegatëve rajonalë të APFA. Delegatët prezantuan shqetësimet e kolegëve të tyre në lidhje me vendin e të mesuarit të gjuhës frënge. Së pari, duke qenë se Shqipëria është anëtare e OIF që nga viti 1999 dhe shoqata jonë anëtare e FIPF, Shoqata e mësuesve të gjuhës frënge të Shqipërisë kërkon që mësimi i gjuhës frënge të ketë vendin e saj në kurrikulën e re duke respektuar plurilinguizmin dhe detyrimet si anëtare e OIF, sipas të cilit 30% e nxënësve shqiptarë duhet të studiojnë frëngjishten si gjuhë e huaj e parë . Çdo vit shkollor, Ministria e Arsimit dhe Sportit u kërkon shkollave të respektojnë këtë përqindje (Udhëzime për fillim vitin 2020-2021 pika c,d faqe 32)	APFA		

	Së dyti, pasi kemi lexuar me kujdes propozimet për strategjitë e reja (Ref A.3 5.1, 5.2 të strategjive të reja të mësimdhënies 2021-2026) ne insistojmë që gjuha frënge si gjuhë e dytë e huaj duhet të jetë e detyrueshme nga klasa e tretë në klasën e 12-të. Së treti, në qytete ku ka seksione dygjuhëshe (Tiranë, Elbasan, Korçë, Durrës, Shkodër) vazhdimësia e këtij projekti rrezikohet nga heqja e frëngjishtes si gjuhë e huaj e pare. Ne propozojmë të respektohet marrëveshja administrative e nënshkruar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Francës dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Shqipërisë. Shkollat nëntëvjeçare në qytetet përkatëse duhet të furnizojnë seksionet dygjuhëshe frankofone me nxënës. Ne kërkojmë që frëngjishtja të vazhdojë të jetë gjuhë e parë nga klasa e pare			
112. Disa rekomandime dhe sugjerime në përgjithsi	A1.7.6 Përdorimi i orëve të lira të lëndëve të qytetarisë ose Shërbimit Komunitar në shkolla në mënyrë të qëllimshme dhe si pjesë e planit vjetor të shkollës për organizimin e aktiviteve që promovojnë qytetarinë aktive dhe kohezionin social në shkolla. A1.7.7 Mbështetja e shkollave për të hartuar dhe zbatuar vetë projekte për krijimin e ambienteve të sigurta, miqësore dhe gjithëpërfshirëse bazuar mbi udhëzimet e Ministrisë së Financave për menaxhimin e fondeve në nivel shkolle. Produkti A2.2. Shtimi i mundësive për zhvillimin profesional të mësuesve (aftësitë pedagogjike, kompetenca digjitale, arsimit gjithëpërfshirës): A2.2.1.b. Zhvillimi i moduleve/ programeve të trajnimit dhe materialeve burimore për mësues që promovojnë kompetencën e qytetarisë dhe aktivizmit të fëmijëve dhe adoleshentëve. A2.2.3 Trajnimi i vazhdueshëm i mësuesve dhe Komisionit të Sigurisë dhe Shëndetit në shkolla mbi hartimin dhe përditësimin	WVA WORLD VISION ALBANIA	Refuzohet	Lidhur me zhvillimin profesional të mësuesve rekomandimet do të merren në konsiderate në momentin e hartimit të moduleve të trajnimit konkrete. Nuk vendosen në strategji. Zejet dhe artet janë përfshirë.

	e planeve të emergjencave në shkolla në bashkëpunim dhe me komunitetin e prindërve dhe pushtetin vendor. Produkti A3.6. Të mësuarit e zejeve dhe të arteve në arsimin e mesëm të lartë në kuadrin e kurrikulës me zgjedhje: A3.6.3. Hartimi moduleve kurrikulare dhe profesionale dhe trajnimi i mësuesve me fokus në aftësitë për jetën/ aftësitë e buta të fëmijët dhe adoleshentët: komunikimi, bashkëpunimi, puna në grup, të folurit në publik, aktivizmi rinor dhe vendimarrja e të rinjve etj në kuadër të kurrikulës me zgjedhje.			
113.Edukimi mjedisor	Sygjerojnë që edukimi mjedisor si pjesë e kurrikulës alternative/ mësimor plotësues dhe programve të trajnimit të bëhen pjesë e angazhimit të shprehur politik dhe në kuadër të Strategjisë së Arsimit. Strategjia ti bënte një trajnim të thellë dhe serioz dëmit në nxënie dhe aftësitë e nxënësve për të mësuar, mbështetur në analizën e shkollimit online të dy viteve të fundit. e cila do të gjeneronte një sërë çështjesh që duhet të shqyrtohen (si çështja e aksesit në internet, përmbajtja digjitale, kontrolli dhe evlerësimi, humbjet në njohuri) për të hapur rrugën planeve të rimëkëmbjes.	REC Albania	Refuzuar	Është trajtuar në strategji
114. Gjuha e urrejtjes në shkolla	Qendra CVE dëshiron të sjellë në vëmendjen tuaj përfshirjen e tematikave që flasin për edukimin ndërkulturor, barazinë, dhe minimizimin e gjuhës së urrejtjes duke e lidhur me konceptin e gjithëpërfshirjes në kurrikulën bazë si një qasje që edukon të rinjtë dhe i mban larg sjelljeve radikale apo ekstreme të dhunshme.	Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm	Pranuar	Minimizimi i gjuhës së urrejtjeve është shtuar te radikalizimi
115. Punonjësit psiko-social	Evidentojmë me rëndësi zhvillimin e kapaciteteve të mësuesëve, punonjësve psiko-socialë, punonjësëve të sigurisë në shkollë në identifikim, parandalim dhe riintegrim të nxënësve që shfaqin sjellje radikale apo ekstreme të dhunshme në shkollë, si një aktivitet që do të garantonte siguri dhe stabilitet në shkollë.	Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm		

	Me interes të veçantë konsiderojmë ndërhyrjet që duhen realizuar në sistemin universitar duke u përqendruar tek nevoja për përfshirje në kurrikulën bazë të profilit mësuesi, psikologji, punë sociale apo gazetari të tematikave që rrisin kapacitetet e profesionistëve të ardhshëm në identifikim, parandalim dhe riintegrim të individëve që shfaqin sjellje ekstreme të dhunshme.			
116. Produkti C.2.1.3	Propozohet: Të shtohet Produkt C.2.1.3, si më poshtë: Masa nxitëse për bashkëpunime institucionale, të strukturuar midis akademikëve të diasporës dhe IAL. Këto bashkëpunime mund të jenë në formën e granteve për projekte të përbashkëta kërkimore, mentorim diplomash doktorature, përditësim dhe krijim kurrikulash dhe programesh të reja, në përputhje me nevojat e tregut. Masat nxitëse mund të përfshijnë financim, lehtësim të procedurave ligjore dhe administrative.	AADF		
117. Produkti C2.1.2	Të zgjerohet Produkt C2.1.2, si më poshtë: Financime për publikime në revista ndërkombëtare me faktor të lartë impakti. Deri tani paga e pedagogëve varet vetëm nga orët e mësimdhënies. Studimi i fizibilitetit i zhvilluar nga AADF ka vlerësuar se shuma optimale për të nxitur akademikët shqiptarë për publikime në revista ndërkombëtare me faktor të lartë impakti (Q1 dhe Q2) është \$1,000. Financimi i AADF: \$2.7 milion	AADF		
118. Struktura qeverisëse pika 3.4.3	MASR ka nënshkruar me AADF më 4 Tetor 2018 një Memorandum Mirëkuptimi për “Rritjen e Kapaciteteve dhe Fuqizimin e QSHA-së”. Si pjesë e kësaj iniciative, AADF ka financuar përmirësimin e infrastrukturës teknologjike në QSHA duke mundësuar edhe korrigjimin e automatizuar të provimeve që nga viti 2019. Gjithashtu si pjesë e financimit të AADF janë realizuar, në bashkëpunim me Cambridge Assessment International Education, “Raporti Strategjik” për analizën e situatës aktuale dhe propozimin e një modeli të rishikuar të	AADF		

	funkcionimit të QSHA-së sipas praktikave më të mira ndërkombëtare, si dhe një “Plan Biznesi” i detajuar për zbatimin e modelit të ri. Ky model parashikon autonominë operacionale e financiare të institucionit, si dhe përmirësimin e shërbimeve aktuale dhe përfshirjen e shërbimeve të reja që do të plotësojnë nevojat e sistemit arsimor. Si pjesë e këtij projekti të përbashkët me MASR për transformimin e QSHA-së, AADF ka angazhuar një fond prej 5.2 milion dollarë dhe ka investuar deri tani rreth 200 mijë dollarë. Propozohet: Një narrativë e shkurtër e këtij projekti të përfshihet në strategji, si pjesë e “Objektivi specifik B2: Niveli i sistemit” si: Produkt B2.4.3. Transformimi i QSHA-së në Agjencinë për Monitorimin dhe Vlerësimin e Arsimit si një institucion autonom i vetëfinancuar që siguron shërbime cilësore dhe transparente në sistemin arsimor bazuar në praktikatat më të mira ndërkombëtare. Treguesi: Transformimi i QSHA në bashkëpunim me AADF në një agjenci autonome dhe të vetëfinancuar deri në vitin 2024. Financimi i AADF: \$5.2 Milion			
119. Objektivi Specifik C7: Shërbimet digjitale/ Produkti C7.2.1. (faqe 102).	Që para fillimit të pandemisë së shkaktuar nga Covid-19, universitetet më të mira botërore kishin investuar shumë dhe përdornin teknologjinë dhe mësimin hibrid (i kombinuar, në klasë dhe nëpërmjet platformave në internet) në mënyrë të konsiderueshme. Me fillimin e pandemisë, këto universitete u përshtatën menjëherë, duke i kaluar të gjitha aktivitetet e tyre në formatin në distancë nëpërmjet internetit, ndërkohë që për universitetet në Shqipëri ishte mjaft e vështirë dhe situata e pandemisë i gjeti të papërgatitura. Me gjithë përpjekjet e universiteteve shqiptare për t’u përshtatur me situatën e re të krijuar, duhet theksuar se u shfaqën shumë problematika dhe	AADF		

	iniciativat ishin të nxituara dhe nuk arritën të përmbushnin plotësisht dhe cilësisht nevojat e studentëve dhe pedagogëve. Nga analizat e bëra për impaktin e pandemisë nga institucione prestigjioze si Deloitte , Microsoft etj. është e qartë që transformimet e ndodhura për shkak të pandemisë nuk do të rikthehen më pas në formën që ishin më parë. Analizat theksojnë se institucionet e arsimit të lartë do të shkojnë përtej mësimi hibrid dhe drejt institucionit arsimor hibrid, ku të gjitha shërbimet, dhe jo vetëm mësimi, të mundësohen në formën me prezencë fizike dhe përmes internetit. Kjo do t'i hapte më shumë institucionet e arsimit të lartë drejt grupeve të cilat deri më tani e kanë pasur të pamundur qasjen në IAL për arsye të shumta objektive. Ky transformim në IAL hibride u mundëson gjithashtu institucioneve optimizimin e burimeve duke ulur nevojat për ambiente fizike dhe staf ndihmës. Digjitalizimi i plotë i shërbimeve dhe proceseve do të mundësojë edhe analiza më të sakta, të plota, të shpejta dhe nëpërmjet përdorimit të modeleve kompjuterike ML (Machine Learning) dhe AI (Artificial Intelligence). Krahas sa më sipër, një pikë mjaft e rëndësishme që duhet shtuar në strategji si Produkt është ndërtimi i standardeve për sistemet e informacionit dhe të komunikimit për institucionet e arsimit të lartë. Sigurimi i qasjes në LSM për universitetet publike nga RASH është një iniciativë me shumë vlerë, por e pamjaftueshme, pasi në këtë iniciativë janë lënë jashtë fokusit universitetet private, të cila mbulojnë tashmë rreth 23% të studentëve të arsimit të lartë. Rishikimi dhe miratimi i kuadrit ligjor, që rregullon funksionimin e arsimit të lartë hibrid duke përdorur komunikimin përmes internetit, duhet të jetë një objektiv i veçantë dhe specifik që të realizohet sa më parë për të			
--	--	--	--	--

	mundësuar zhvillimet e shpejta në drejtim të digjitalizimit të arsimit.			
120. Sugjerime të përgjithshme	Propozohet: Një narrativë e shkurtër për sa më sipër të përfshihet në strategji, si pjesë e “Produkt C7.2. Nxitja e IAL-ve për të organizuar mësimin në distancë dhe të nxënin e kombinuar.” Të shtohet Produkt C7.4.1, si më poshtë: Hartimi i Standardeve për Sistemet e Informacionit dhe të Komunikimit në Internet për IAL-të publike dhe private në Shqipëri bazuar në modelet dhe eksperiencat më të mira ndërkombëtare, të kontekstualizuara për realitetin dhe mundësitë në vendin tonë. Standardet duhet të mbulojnë 3 aspekte të rëndësishme të sistemeve elektronike si: Performanca, Siguria dhe Mbrojtja e Përdoruesve. Treguesi: Standardet për Sistemet e Informacionit dhe të Komunikimit në Internet për IAL-të publike dhe private në Shqipëri të miratuara dhe pjesë e kriterëve kyçe për akreditimin e programeve të studimit dhe të institucioneve të arsimit të lartë. Financimi i AADF: \$20 Mijë Të shtohet Produkt C7.4.2, si më poshtë: Përditësimi i ligjit për Arsimin e Lartë dhe miratim i akteve të nevojshme nënligjore për rregullimin e funksionimit të institucioneve dhe programeve të studimit hibride të arsimit të lartë. Treguesi: Ndryshimet e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe aktet e nevojshme nënligjore për rregullimin e funksionimit të institucioneve dhe programeve të studimit hibride të arsimit të lartë të miratuara. Financimi: AADF 30 Mijë Dollarë	AADF		
121. Produkti B.1.2.1	Produkti B1.2 Përmirësimi i drejtimit e menaxhimit të institucioneve arsimore (faqe 87) Propozohet:	AADF	Refuzohet	Janë specifike për ti përfshirë në strategji

	Tek Produkt B.1.2.1 Trajnimi i drejtuesve të shkollave, të shtohet edhe trajnimi i drejtuesve të institucioneve të arsimit parashkollor (kopshtet) përmes bashkëpunimit të ASCAP me Shkollën e Drejtorëve të Institucioneve të Arsimit Parauniversitar.			
122. Arsimi parauniversitar (faqe 32-38)	Propozohet: AADF propozon të shtohet një paragraf mbi rëndësinë e edukimit financiar dhe rolin e Junior Achievement Albania (JAA) në bashkëpunim me AADF-në si më poshtë: AADF prej vitit 2012 ka asistuar MASR në pilotimin dhe përfshirjen në kurrikulën bazë dhe atë me zgjedhje të arsimit parauniversitar, të kompetencës së sipërmarrjes, nëpërmjet një investimi prej 5.3 milion dollarë në periudhën 2012- 2021. Në kuadër të kësaj ndërhyrjeje, janë akredituar 8600 mësues të arsimit parauniversitar për medotat e mësimdhënies së kurrikulës me bazë kompetence, dhe tejçimit të kompetencës së sipërmarrjes dhe edukimit ekonomik tek nxënësit e këtij cikli. AADF nëpërmjet investimit në JAA është angazhuar në trajnimin e plotë të 14000 mësuesve të arsimit fillor dhe atij të mesëm të ulët në vend.	AADF	Pranohet	
123. Disa sugjerime mbi strategjinë	- Respektimi i parimit të barazisë dhe gjithëpërfshirjes në mënyrë që të ndihmojmë në rritjen e qytetarëve të mirë dhe jo thjesht nxënësve të zgjuar dhe të arrirë profesionalisht. - Mbështetja e krijimit të këshillave kolegjalë brenda shkollave (të nxënësve dhe prindërve), në mënyrë që të përmirësohet atmosfera nëpër shkolla dhe qasja ndaj nxënësit të jetë më miqsore. - Përmirësimi i infrastrukturës nëpër shkolla për nxënësit me aftësi të kufizuara brenda këtij katër vjeçari, pavarësisht nëse bëhet fjalë për shkolla nëpër zona urbane apo rurale dhe nëse shkolla ka në atë periudhë nxënës me aftësi të kufizuara apo jo.	(Komisioneri për Mbrotjen nga Diskriminimi)	Refuzohet	Rishikimi i teksteve shkollore për shkak se ka sinjalizime për tekste që nxitin stereotipe tek nxënësit.- të refuzohet. Nga vlerësimet e shkollave nuk ka rezultuar të ketë dicka të tillë.

	- Ofrimi i shërbimit psiko – social, rritja e numrit të psikologëve dhe punonjësve socialë nëpër shkolla në mënyrë që të parandalojmë në të ardhmen situata të caktuara. - Shtimi i mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara. - Rritja e sigurisë nëpër shkolla. - Rishikimi i teksteve shkollore për shkak se ka sinjalizime për tekste që nxitin stereotipe tek nxënësit. - Krijimi dhe nxitja e mekanizmave efektivë për ndalimin e bullizmit nëpër shkolla nëpërmjet mbështetjes së këshillave të nxënësve. - Nxitja e debateve, garave dhe konkurseve midis shkollave.			Refuzohet pjesa e rishikimit. Nga vlerësimet e shkollave nuk ka rezultuar të ketë dicka të tillë.
124. Mbështetja me bazë materiale e nxënësve	Mbështetja me bazë materiale e nxënësve për talentet e tyre në mënyrë që shkolla të bëhet më tërheqëse.	Shkolla “Dom Nikollë Kaçorri”, Durrës:	Refuzohet	Në draft-strategji është përcaktuar A3.1.2. Shpërndarja e paketave me mjete mësimore në shkolla. Pasi të jetë përcaktuar përmbajtja minimale e paketës mësimore, do të evidentohen mjetet që janë në përdorim në shkolla dhe do të hartohet një plan i furnizimit të shkollave me mjetet mësimore që mungojnë.
125. Vlerësimi i mësuesve	Një problematikë në zonën e Kurbinit është hartimi i formave të vlerësimit të nxënësve, dmth të testet. Ndonjëherë nuk e dimë nëse po testohemi në mësimet që kemi studiuar dhe ndonjëherë	-shkolla “Nr. 3”,Kurbini	Refuzohet	Në draft strategji është i përcaktuar ky rekomandim "

	ne cuditemi kur përgjigja jonë del e pasaktë. A keni menduar për trajnimin e mësuesve për vlerësin e nxënësve?			A3.3.1. Mbështetja e zbatimit të praktikave të reja të vlerësimit të nxënësve. Në përputhje me rekomandimet e OECD-së, do të mbështeten mësuesit në mënyrë të vazhdueshme, duke vënë theksin në vlerësimin formues dhe mënyrën e shfrytëzimit të rezultateve të tij për të përmirësuar të nxënësit."
126. Vlerësimi i nxënësve	Në gjithë shqipërinë përdoret e njëjta formë vlerësimi për njohuritë. Si mendoni, a duhet të ndryshojë mënyra e vlerësimit të njohurive dhe a duhet të merret për bazë, a duhet të merren në konsideratë llojet e ndryshme të inteligjencës së nxënësve?	shkolla "100 vjetori" Kamëz	Refuzohet	Vlerësimi i nxënësve në kurrikulën me kompetenca synon pikërisht progresin e nxënësve dhe motivimin e tyre për arritjet, mbështetur në pikat e forta dhe nevojat e nxënësve për përmirësim. Dhe në draft strategji është

				përcaktuar "A3.3.1. Mbështetja e zbatimit të praktikave të reja të vlerësimit të nxënësve. Në përputhje me rekomandimet e OECD-së, do të mbështeten mësuesit në mënyrë të vazhdueshme, duke vënë theksin në vlerësimin formues dhe mënyrën e shfrytëzimit të rezultateve të tij për të përmirësuar të nxënit."
127. Siguria në shkolla	Doja të prekja pak temën e sigurimit në shkollë sepse në shumë shkolla nuk ka një security apo roje që mund të ndihmojë për ndonjë debat të agravuar midis 2 nxënësve. Keni menuar ju ndonjë zgjidhje për këtë?	shkolla "Dom Nikoll Kacorri" në Durrës	Refuzohet	Është adresuar në strategji
128. Trajnimi I mësuesve	Duke qënë se bota rrotullohet shpejt dhe ka shumë ndryshime dhe shumë për të mësuar, a mund të ketë trajnime të shpeshta për mësuesit, sa më aktive dhe ndërvepruese, si trajnimet tona me impaktin por që të mos jenë të lodhshme por sa më efikase?	shkolla 9 vjecare Fushë – Mamurras "Ismail Dema".		Po, është menduar në trajnimin e mësuesve
129. Nxënësit	Në shkollën time ka nxënës që kanë talente në degë të ndryshme dhe duke marrë parasysh përvojën që kemi patur me mësimin në distancë, a mund të përdoren për punë të përforcuar me nxënësit	shkolla "100 vjetori" Kamëz		Po, do të merren parasysh gjatë vitit të ardhshëm

	por që dhe mësuesit të kenë punë më specifike për këtë dhe për nxitjen?			
130. Sugjerime	Faqe 24; Koment: Pjesa e qarkuar me blu në të cilën në skem deklarohet se një student mund të transferoj ECTS ne BSc është e pasaktë. Këtë e ndalon Ligji i Arsimit të lartë pasi studentët nuk mund të transferohen nga një cikël me i ulët në një më të lartë, transferimi lejohet veten ne programe të të njëjtit cikël. Gjithashtu që prej vitit 2017 studentët që pranohen në këto programe studimi Bachelor dhe diploma profesionale dy vjecare diferencohen nga mesataria në hyrje. Faqe 25 Duhet paragraf me vete kjo pjese: Institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri ofrojnë programe të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS)..... Faqe 28 Eshte: Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) është institucion në varësi të MASR-së që mbikëqyr dhe vlerëson cilësinë e institucioneve dhe programeve të arsimit të lartë nëpërmjet mekanizmave të sigurimit të cilësisë, akreditimit dhe proceseve të tjera. DUHET: Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) është person juridik publik. Ajo është përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. ASCAL, përmes mekanizmave të sigurimit të cilësisë, akreditimit dhe proceseve të tjera, monitoron dhe vlerëson cilësinë e institucionit dhe të programeve të ofruara. ASCAL mbështet veprimtarinë e saj mbi udhëzuesit e saj, në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, i cili	ASCAL		

	përditësohet me standardet dhe udhëzuesit europianë të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë			
131.Sugjerime	Faqe 28 Nga faqja 28 deri ne fund jo ASCAL-ja por ASCAL-i Faqe 56 Eshte: Duke filluar nga viti 2015 të gjitha institucionet e arsimit të lartë i nënshtrohen akreditimit të detyrueshëm nga ASCAL-i. Agjencia gëzon autonomi në adoptimin e procedurave dhe kriterëve të vlerësimit, si dhe në angazhimin e ekspertëve përkatës. DUHET: Duke filluar nga viti 2007 të gjitha institucionet e arsimit të lartë i nënshtrohen akreditimit të detyrueshëm nga ASCAL-i. Agjencia gëzon autonomi në hartimin e procedurave dhe kriterëve të vlerësimit, si dhe në angazhimin e ekspertëve përkatës. Koment: Arsye pse duhet vitin 2007 eshte sepse doli ligji i ri i arsimit te larte 9741/2007, në të cilin akredimi instiucional dhe I programeve ishte I detyrueshem. Eshte:: Megjithatë, procesi i akreditimit nuk shoqërohet me mbikëqyrje të vazhdueshme të institucioneve të arsimit të lartë për t'u siguruar se ato i përmbahen kushteve të akreditimit. DUHET: Përveç plotësimit të rekomandimeve të dhëna në vendimin e Bordit të akreditimit (të cilat janë detyrim për t'u plotësuar nga çdo IAL), periudha midis dy akreditimeve nuk shoqërohet me mbikëqyrje të vazhdueshme të institucioneve të arsimit të lartë për t'u siguruar se IAL nuk e ulin cilësinë e vlerësuar gjatë akreditimit.	ASCAL		
132. Sugjerime	Faqe 92	ASCAL	Refuzohet	Eshte:

	Eshte: Procesi i akreditimit nuk shoqërohet me mbikëqyrje të vazhdueshme të institucioneve të arsimit të lartë për t'u siguruar se ato i përmbahen kushteve të akreditimit. DUHET: Periudha midis dy akreditimeve nuk shoqërohet me mbikëqyrje të vazhdueshme të institucioneve të arsimit të lartë për t'u siguruar se IAL-të nuk e ulin cilësinë e vlerësuar gjatë akreditimit. Faqe 92			Produkti C1.3. Aplikimi i standardeve të larta akademike për akreditimin e IAL-ve dhe të programeve studimore C1.3.1. Ristrukturimi i Sistemit të Sigurimit të Cilësisë për të siguruar pavarësinë dhe për të garantuar zbatimin e SUE-s. Do të rishikohet korniza ligjore në mënyrë që të lejojë zbatimin e plotë të SUE-s, si dhe do të bëhet rishikimi i Kodit të Cilësisë për të pasqyruar standardet e SUE-s. Në përputhje me praktikat më të mira evropiane do të ndërtohen mekanizma për të garantuar përfshirjen më të
--	--	--	--	--

				gjerë të palëve të interesuara në sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë. C1.3.2. Akreditimi i IAL-ve dhe programeve në bazë të standardeve ndërkombëtare dhe mbikëqyrja e vazhdueshme e institucioneve dhe programeve të akredituara do të garantojnë përmirësim të përputhshmërisë të cilësisë së arsimit të lartë me standardet dhe udhëzuesit për sigurim të cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. C1.3.3. Aplikimi për anëtarësim të ASCAL-it me të drejta të plota në ENQA dhe EQAR. Agjencia për Sigurimin e
--	--	--	--	---

				Cilësisë në Arsimin e Lartë do të zhvillojë një strategji për përmbushjen e kushteve për anëtarësim në dy rrjetet evropiane të sigurimit të cilësisë – ENQA dhe EQAR. Treguesit • 50% të programeve të akredituara bazohen mbi rezultatet e të nxënit • Infrastrukturë akademike që përmbush standardet • Anëtarësimi i ASCAL në ENQA dhe EQAR
133.Sugjerime	Në materialin voluminoz të draft strategjisë i cili është për diskutim publik e ndjej të nevojshme të evidentoj disa pika të paraqitura në draft dhe sygjjerime për çështje të ndryshme të politikave arsimore të cilat do të marrin jetë në zbatim të kësaj strategjie.	DPAP	Pranohet	Po, duhet: Janë kryer trajnime me 33 895 pjesëmarrës, mësues të arsimit parauniversitar (nje mësues mund të ketë kryer disa trajnime) në çështje

	1) Në fund të faqes 37 është shënuar: Në vitin shkollor 2018/19 në shkollat shqiptare punonin 577 psikologë dhe punonjës socialë 2) Në faqen 43 shkruhet: , gjatë vitit 2020 janë trajnuar 33,895 mësues. 3) Në faqen 43 shkruhet: Në këtë kuadër, me mbështetjen e UNICEF-it, është hartuar edhe platforma akademi.al dhe janë trajnuar rreth 1200 mësues të TIK-ut për përdorimin e saj në mësimin online gjatë pandemisë COVID- 19. Në faqen 52 shkruhet: Me mbështetjen e UNICEF-it dhe MASR-së është zhvilluar platforma akademi.al e cila krijon mundësi për të realizuar mësimin online, si dhe të nxëniet e kombinuar në klasë dhe online, ndërsa fushata e Vodafone Albania solli dhurimin e mbi 15 mijë tabletave dhe telefonave për fëmijët në nevojë . 4) Në faqen 53 citohet: Instalimi i strukturës së re qeverisëse në arsimin parauniversitar konsiderohet si arritje, sepse sjell inspektimin më afër shkollës. Megjithatë, strukturat e DPAP-së janë ende në proces të plotësimit me personel sipas skemës së re organizative. Në faqen 53 citohet: Megjithatë, numri i vlerësimeve të jashtme të Shkollës ka qenë mjaft i vogël, si pasojë e numrit të vogël të inspektorëve, gjendje e cila vijon edhe tani kur inspektimi bëhet nga DRAP-të. Edhe në ato raste kur janë dhënë rekomandime për përmirësim nga ana e inspektorëve, nga shkollat nuk është kërkuar të zhvillojnë plane veprimi për trajtimin e tyre			të ndryshme të funksionimit të sistemit arsimor.
--	---	--	--	---

134. Sugjerime	Përfshirjen e tematikave që flasin për edukimin ndërkulturor, barazinë, dhe minimizimin e gjuhës së urrejtjes duke e lidhur me konceptin e gjithëpërfshirjes në kurrikulën bazë si një qasje që edukon të rinjtë dhe i mban larg sjelljeve radikale apo ekstreme të dhunshme. Evidentojmë me rëndësi zhvillimin e kapaciteteve të mësuesëve, punonjësve psiko-socialë, punonjësëve të sigurisë në shkollë në identifikim, parandalim dhe riintegrim të nxënësve që shfaqin sjellje radikale apo ekstreme të dhunshme në shkollë, si një aktivitet që do të garantonte siguri dhe stabilitet në shkollë. Në vijim të këtij propozimi një vëmendje e veçantë duhet treguar drejt fuqizimit të mësuesëve mbështetës të cilët duhet të sigurojnë mbrojtje dhe orientim për kategoritë e nxënësve të përfshirë. Me interes të veçantë konsiderojmë ndërhyrjet që duhen realizuar në sistemin universitar duke u përqendruar tek nevoja për përfshirje në kurrikulën bazë të profilit mësuesi, psikologji, punë sociale apo gazetari të tematikave që rrisin kapacitetet e profesionistëve të ardhshëm në identifikim, parandalim dhe riintegrim të individëve që shfaqin sjellje ekstreme të dhunshme.	Qendra e Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm		
135.Matura	Analizë e maturës, mënyra sesi ne e vlerësojmë maturën në lidhje edhe me provimet e PISA	Qendrës "Maria Mazzarello", Tiranë	Pranuar pjesërisht	Mund të parashikohen materiale ndihmëse për nxënësit e arsimit 9-vjeçar që përfshihen në PISA. 2. Sugjeroj të përcaktohet diçka në lidhje me ndryshimin e administrimit dhe të

				zhvillimit të Maturës Shtetërore. Për pjesën e zhvillimit të testimit mund të rekomandojë më shumë QSHA.
136. kurrikula të përbashkëta	A do të kemi kurrikula të përbashkëta? A kemi komunikim me institucionet e Kosoveës që të paktën në fushat e arsimit kombëtar, që janë: gjuha, kultura, historia, gjeografia, arti dhe pjesë të tjera që ti kemi të përbashkëta. Tek arsimi parauniversitar dhe universitar. Të konsultohet dhe të kemi një strategji të përbashkët me Kosovën.	Ambasadori i Kosovës	Refuzohet	Kurrikula e arsimit parauniversitar është reformuar së fundmi edhe në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Kosovës. Mes dy kurrikulave ka elemente të përbashkëta (synimet, kompetencat, qasja metodologjike etj.), por ato nuk janë të unifikuara. Bashkëpunimi duhet të vijojë, por gjykojme që çështjet për të cilat do të bashkëpunohet, të mos pasqyrohen në strategji, por në

				marrëveshje me dy qeverive. (Anila)
137. Seksionet dygjuhëse	Kjo strategji kërkon më shumë buxhet se në të shkuarën. Ambasada Gjermane pergezon rendesine qe po i jepet futjes se ICT neper shkollat e vendit dhe kerkojne qe gjuha gjermane te vazhdoje te mbetet gjuha e huaj e pare sipas marreveshjes ne shkollat qe zbatojne seksionet dygjuheshe shqiptaro-gjermane	Ambasadori Gjerman		
138. Erasmus+	Investimi tek të rinjtë është investimi më i mirë për një të ardhme më të mirë. Gjuha e huaj e dyte do te jete gjuhe e huaj e detyrueshme apo gjuhe e huaj e dyte me zgjedhje te detyrueshme. Permes programit ERASMUS + shume studente shqiptare kane shkuar ne France, dhe kane nje standart dhe arritje shume te mira, dhe mendojme qe investimi ne kete bashkepunim eshte nje gje shume e mire. Shqiperia do te behet anetare e plote e ERASMUS, te krijoje agjencine dhe ku mund te perfshihet kjo ne strategji? Vendet e tjera te Ballkanit Perendimor kane krijuar tashme agjencite e tyre ERASMUS.	Ambasadori Francës	Refuzohet	Në draftstrategji është përcaktuar që gjuha e dytë do të jetë e detyrueshme. Në lidhje me komentën " Gjuha e huaj e dyte do te jete gjuhe e huaj e detyrueshme apo gjuhe e huaj e dyte me zgjedhje të detyrueshme", në dokumentin e draft-strategjisë (Pika "A3.5.2 Futja e gjuhës së huaj të dytë nga klasa e tretë") kjo gjë duhet permiresuar . Për arsimin bazë, gjuha e huaj e dytë është përfshirë si lëndë e detyrueshme në planin mësimor të

				arsimit bazë , duke filluar nga klasa 6, të miratuar më 01.06.2021 dhe kjo sugjerojme që duhet të reflektohet dhe në dokumentin e draft-strategjisë.
139.Praktika e mësuesve	Objektivi specifik A2 "Krijimi i mundësive për trajnim cilësor të mësuesve dhe përmirësimi i një sistemi karriere që i inkurajon ata të zhvillojnë nivele më të larta të aftësive mësimore." - - Si është përfshirë praktika në programin e diplomës? - Si është e organizuar praktika? - Si shoqërohet praktika profesionalisht nga mësues (mentorë) dhe pedagogë të universitetit? Propozimi: Fokusi, megjithatë, është veçanërisht në teorinë e bazuar. reflektim mbi përvojën praktike dhe si përmbajtja akademike dhe aspektet e rëndësishme për praktikën janë të lidhura me njëra-tjetrën si në fazat praktike ashtu edhe në kontekstin e kurseve universitare. Prandaj, praktika e rritur mund të jetë e suksesshme vetëm nëse një rritje sasiore e proporcionit të praktikës shkon paralel me modelin përkatës cilësor. Si pasojë, fokusi është në pasqyrimin e bazuar në teori të përvojave praktike dhe çështjen se si përmbajtja akademike dhe aspektet e lidhura me praktikën janë të lidhura me njëra-tjetrën si në fazat praktike ashtu edhe brenda kornizës së kurseve universitare. Prandaj, praktika e rritur mund të jetë e suksesshme vetëm nëse një rritje sasiore e proporcionit të praktikës shkon paralelisht me modelin përkatës cilësor. Prandaj lind pyetja për sa i përket dizajnit konkret në detaje dhe zbatimit efikas të lidhjes teori-praktikë në këtë drejtim. Me fjale te tjera: Kërkesa	Këshilli i Evropës	Refuzohet	Lidhet më shumë me arsimin e lartë

	për më shumë praktikë ka kuptim vetëm nëse përfaqësuesit e praktikës (mësuesit dhe drejtorët) së bashku me përfaqësuesit e arsimit universitar (lektorë dhe dekanë) së bashku sqarojnë kornizën e kushteve dhe referencat reciproke dhe kuptojnë dhe përshkruajnë rëndësinë e roleve përkatëse.			
140. Objektivi specifik A3	Objektivi specifik A3 "Zotërimi i kompetencave të të mësuarit gjatë gjithë jetës" - Zbatimi i plotë i kurrikulës së bazuar në kompetenca përmes mësimdhënies efektive dhe përdorimit të burimeve me cilësi të lartë. Plani i menduar mirë për të siguruar zbatimin e kurrikulës së re, vlerësimi formues si një rrugë përpara është ndryshimi shumë i mirëpritur në sistem. Megjithatë përmendet cilësia e librave shkollorë, nuk përmendet kontrolli i cilësisë. Mund të jetë që ai të jetë në sistem tashmë, megjithatë kriteret për zgjedhjen e librave shkollorë duhet të kontrollohen dhe të vendosen në parime gjithëpërfshirëse të tilla si ndjeshmëria gjinore, çdo prezantim stereotip ose diskriminues i ndonjë grupi etj. Propozimi: Kontrolloni kriteret e zgjedhjes së teksteve shkollore siguroni që parimet gjithëpërfshirëse dhe të të drejtave të njeriut janë të përfshira në kritere	Këshilli i Evropës		Në lidhje me komentin Megjithatë përmendet cilësia e librave shkollorë, nuk përmendet kontrolli i cilësisë. Mund të jetë që ai të jetë në sistem tashmë, megjithatë kriteret për zgjedhjen e librave shkollorë duhet të kontrollohen dhe të vendosen në parime gjithëpërfshirëse të tilla si ndjeshmëria gjinore, çdo prezantim stereotip ose diskriminues i ndonjë grupi etj. Propozimi: Kontrolloni kriteret e zgjedhjes së teksteve shkollore siguroni që parimet gjithëpërfshirëse

				dhe të të drejtave të njeriut janë të përfshira në kriteret" sugjeroj të refuzohet. Tekstet shkollore janë hartuar dhe janë vlerësuar mbi bazën e dokumentit "Standardet e teksteve shkollore". Në këtë dokument ka standarde (standartet 9-12) për barazinë gjinore, tolerencën, mirëkuptimin, pranimin e kulturës së tjetrit etj. Tekstet janë vlerësuar mbi bazën e këtyre standardeve në një proces konkurrimi dhe nga ky proces kanë dalë deri në tri alternativa fituese. Mësuesit përzgjedhin një të një nga këto alternativa.
--	--	--	--	---

				Sugjeroj që përzgjedhja nga mësuesit e njërës prej tri alternativave të teksteve shkollore, të bëhet mbi bazën e disa kriterëve që përfshijnë edhe cështjet në rekomandim. Për këtë mund të hartohet një instrument vlerësimi, por ky element (micro) nuk ka pse të jetë pjesë e strategjisë së ardhshme.